



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 mars 2023
Nr. ref.:MM 2141/23

MENDIM MOSPAJTUES

i gjyqtarit

RADOMIR LABAN

në

rastin nr. KI108/22

Parashtrues

“Metalinvest SH. A.”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-19-0213]
të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për
çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 16 marsit 2022**

Duke shprehur që në fillim respektin dhe pajtimin tim me mendimin e shumicës së gjyqtarëve se në këtë rast ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ),

Megjithatë, unë si gjyqtar individual kam një mendim mospajtues në lidhje me përfundimin e shumicës dhe nuk pajtohem me mendimin e shumicës. Konsideroj se nuk ka shkelje të së drejtës për seancë dëgjimore nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së në mënyrën se si është paraqitur në aktgjykim.

Fillimisht, dua të theksoj se ky mendim mospajtues nga ana ime, si gjyqtar individual, ishte i vonuar dhe se fajin e kam vetëm unë që nuk e kam shkruar një mendim mospajtues menjëherë në aktgjykimin e parë, kur është konstatuar shkelja e të drejtës në seancë dëgjimore. Ndonëse në tri vitet e mëparshme vazhdimisht kam votuar kundër qëndrimit të shumicës dhe në seanca kam argumentuar arsyet se përse besoj se nuk ka shkelje të së drejtës për seancë dëgjimore, nuk kam shkruar mendim mospajtues. Kjo ka ndodhur sepse kam konsideruar se me vendimet e para të gjykatave të rregullta, shumica e gjyqtarëve do të

shohin se parashtruesit e kërkesës nuk përfitojnë nga vendimet e tilla. Përkundrazi, qëndrimi i shumicës së gjyqtarëve me vendime të tilla i ekspozon parashtruesit e kërkesave ndaj procedurave dhe shpenzimeve shtesë gjyqësore, ndërsa në të njëjtën kohë ata nuk kanë mundësi të realizojnë të drejtën e tyre thelbësore për të cilën e kanë filluar procedurën. Kam menduar se shumica e gjyqtarëve kur ta shohin këtë do ta ndryshojnë qëndrimin, sepse asnjë parashtrues i kërkesës nuk iu drejtua Gjykatës Kushtetuese vetëm për të pasur të drejtën në seancë dëgjimore ose ndonjë të drejtë tjetër procedurale, përkundrazi çdo parashtrues iu drejtua gjykatës. për të realizuar ndonjë të drejtë materiale, pra një të drejtë efektive të cilën ai e konsideron se i takon. Duke pasur parasysh se qëndrimi i shumicës së gjyqtarëve nuk ka ndryshuar as pas vendimeve të para të gjykatave të rregullta, nga ku u bë plotësisht e qartë se vendimet e tilla i ekspozojnë parashtruesit e kërkesave ndaj shpenzimeve shtesë dhe procedurave të reja gjyqësore që janë rreptësisht formale për sa i përket mbajtjes së seancës ku nuk paraqitet asnjë provë por vetëm konstatohet se seanca është mbajtur, konsideroj se jam i detyruar të shpreh mendimin mospajtues. Për të gjitha sa më sipër, kam vendosur të shpreh me shkrim mospajtimin tim me mendimin e shumicës për të kundërshtuar në mënyrën më të qartë të mundshme, për mendimin tim, praktikën krejtësisht të gabuar dhe të pasaktë gjyqësore.

Unë si gjyqtar pajtohem me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në aktgjykim dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, unë si gjyqtar pajtohem me mënyrën se si janë parashtruar dhe paraqitur në aktgjykim pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe i pranoj të njëjtat si të sakta.

Megjithatë, nuk pajtohem me analizën ligjore lidhur me pranueshmërinë e rastit dhe mendimin e shumicës se ka shkelje të së drejtës në seancë dëgjimore siç është deklaruar dhe paraqitur në aktgjykim dhe mospajtimin tim do ta arsyetoj në hollësi.

Për sa më sipër, dhe në pajtim me rregullat 61 dhe 63 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, dhe për të ndjekur sa më lehtë dhe qartë arsyetimin e mendimit tim mospajtues **(I)** do të përsëris pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave; **(II)** të paraqes përmbajtjen e dispozitave relevante kushtetuese dhe ligjore **(III)** të arsyetoj parimet bazë në lidhje me të drejtën në seancë dëgjimore nga nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; **(IV)** të arsyetoj në detaje rastet në të cilat GJEDNJ arsyetoi se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca publike, **(V)** të zbatojë parimet bazë të mësipërme në rastin konkret; **(VI)** të nxjerr një përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

(I) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave

1. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafi 1 dhe 2, nenin 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
2. Në mbështetje të pretendimeve, parashtruesi i kërkesës shton:

“Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me vendimin e saj C – IV 14 – 5731, datë 21.11.2019, me të cilin është rrefuzuar kërkesëpadia e këtu parashtruesit të ankesës Subjektit “Metalinvest” S.H.A. me arsyetim se kërkesa është parashkruar si dhe vendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së

Posaçme të Gjykatës Supreme AC – I – 19 – 0213 të datës 16.04.2022 pos shkeljeve ligjore të LMD të përshkruar si më lartë paraqet edhe shkelje të parimeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përkatësisht nenit 24, nenit 31 paragrafët 1 dhe 2, nenit 54 si dhe neni 102 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Këtë pretendim e mbështesim në faktin se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme duke mos vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë të fakteve të lëndës trajton palët në një proces gjyqësor në mënyrë jo të drejtë dhe diskriminuese”.

3. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se “Në kundërshtim me nenin 31 paragrafi i dhe 2 dhe nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me vendimin e saj C – IV – 14 – 5731 të 21.11.2019, si dhe Vendimi i Kolegjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC – I – 19 – 0213 të 16.04.2022, palëve në procedurë nuk i është mundësuar një gjyqësore me të cilën procedurë do të i mbrohen të drejtat e palëve duke mos caktuar fare seancë gjyqësore dhe duke vendosur një bazë të një vlerësimi të provave jashtë seance gjyqësore. Mohimi i deklaramit të palëve në një procedurë gjyqësore është shkelje e të drejtave të njeriut për një proces të drejtë duke i pamundësuar palëve deklaramin apo plotësimin e çdo prove me të cilën do të argumentohet e drejta e pretenduar. Kjo mënyrë e vendosjes është në kundërshtim edhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut të cilat pretendime janë parashtruar edhe në ankesë, ndërsa Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nuk ka vlerësuar dhe nuk ka arsyetuar këto pretendime të palëve në procedurë. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i ka mohuar palës deklaramin në një proces gjyqësor duke mos mbajtur seancë gjyqësore për deklaramin lidhur me provat dhe pretendimet e palëve në procedurë.

Veprimet juridike të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në një procedurë të tillë gjyqësore bie ndesh edhe me nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duke i pamundësuar qasje të barabartë palëve në një procedurë gjyqësore të paanshme të pavarur të drejtë dhe ligjore”.

4. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim, “të anulohet Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, C– IV – 14 – 5731 të datës 06.12.2019 dhe Aktgjykimi i Kolegjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC – I – 19 – 0213 datë 16.03.2022 si vendime joligjore dhe lënda të kthehet në rigjykim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës”.

(II) Përmbajtja e dispozitave relevante kushtetuese dhe ligjore

5. Në këtë drejtim, fillimisht rikujtoj nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë. [...]

LIGJI nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 10

Aktgjykimet, Aktvendimet dhe Apelet

[...]

11. Në rastet kur kolegji i apelit pranon dhe merr përsipër vendosjen mbi një apel, rregullat në vijim respektohen fuqimisht: 11.1. kolegji i apelit nuk mund të ndryshojë, anulojë, rikthejë apo përndryshe të ndërrojë, në çfarëdo mënyrë, gjetjet faktike të bëra nga një gjykatë, kolegji i specializuar, nën-kolegji apo gjyqtar i vetëm, përveç nëse kolegji i apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme. Gjetja faktike nuk vlerësohet të jetë qartësisht e gabueshme nëse ajo gjetje faktike mbështetet me interpretim të arsyeshëm të dosjes së procedurave gjyqësore dhe provave të parashtruara gjatë atyre procedurave; si dhe 11.2. kolegji i apelit bën shqyrtim, prej fillimit, të secilës çështje që ngrihet nga apeli apo pala kundërshtarë në parashtrësitë e tij/saj me shkrim.

[...]

Shtojca e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rregullorja e Punës e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 36 Rregullat e përgjithshme mbi provat

[...]

3. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë 34 lidhur me pretendimin e tillë.

Neni 64 **Procedurat e ankesës me gojë**

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë apo jo më shumë seanca dëgjimore me gojë lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
[...]

Neni 65 **Paraqitja e provave të reja**

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmohen mirë, Kolegji i Apelit mund t'i lejoj një palë paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t'i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t'i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Ligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 69 **Procedurat e ankesës me gojë**

1. "Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
[...]"

Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006

"[...]
190.4 Gjykata e shkallës së dytë mund ta caktojë shqyrtimin e çështjes edhe kur vlerëson se me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet përsëri të merren të gjitha ose disa nga provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë"

(III) Parimet themelore në lidhje me të drejtën për një seancë dëgjimore nga neni 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së

6. Është parim i përgjithshëm që palët në një kontest kanë të drejtë në dëgjim publik sepse ajo i mbrohet nga administrimi i fshehtë i drejtësisë pa mbikëqyrje publike. Duke e bërë të dukshëm administrimin e drejtësisë, seanca dëgjimore publike kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm të nenit 6 paragrafi 1 – konkretisht, në gjykim të drejtë (*Malhous kundër Republikës Çeke [DHM]*, nr. 33071/96, aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafët 55-56). Edhe pse seanca dëgjimore publike është një nga parimet themelore të përcaktuara në nenin 6, paragrafi 1, detyrimi për të mbajtur një seancë të tillë nuk është absolut (*De Tommaso kundër Italisë [DHM]*, nr. 43395/09, aktgjykim i 23 shkurtit 2017, para. 163). E drejta për një seancë dëgjimore me gojë nuk ndërlidhet vetëm me çështjen nëse procedura përfshin marrjen në pyetje të dëshmitarëve që japin dëshminë e tyre gojariht (*Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë [DHM]*, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 187). Për të përcaktuar nëse gjykimi i plotëson kërkesat në lidhje me publicitetin e procedurës, duhet të shikohen procedurat në tërësinë e tyre (*Axen kundër Gjermanisë*, nr. 8273/78, aktgjykim i 8 dhjetorit 1983, paragrafi 28).
7. Në procedurën e zhvilluar në një gjykatë të shkallës së parë dhe të vetme, e drejta për një “dëgjim publik” sipas nenit 6 paragrafi 1 nënkupton të drejtën për një “seancë me gojë” (*Fredin kundër Suedisë* (nr. 2), nr. 18928/91, aktgjykim i 23 shkurtit 1994, paragrafët 21- 22; *Allan Jacobsson kundër Suedisë* (nr. 2), nr. 8/1997/792/993, aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragraf 46; *Göç kundër Turqisë [DHM]*, nr. 36590/97, aktgjykim i 11 korrikut 2002, paragraf 47; *Selmani dhe të tjerët kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 67259/14, aktgjykim i 9 majit 2017 godine, paragrafët 37-39), përveç nëse ka rrethana të jashtëzakonshme që justifikojnë heqjen dorë nga një dëgjim i tillë (*Hesse-Anger dhe Anger kundër Gjermanisë* (ven.), nr. 45835/99, aktgjykim i 21 majit 2003; *Mirovni Institut kundër Sllovenisë*, nr. 32303/13, aktgjykim i 13 qershorit 2018, paragrafi 36). Karakteri i jashtëzakonshëm i rrethanave të tilla që mund të justifikojnë heqjen dorë nga seanca dëgjimore buron, në thelb, nga natyra e problemit që do të vendoset nga gjykata e brendshme kompetente, për shembull në rastet në të cilat procedura i referohet ekskluzivisht çështjeve ligjore ose çështjeve shumë të specializuara (*Koottummel kundër Austrisë*, nr. 49616/06, aktgjykim i 10 marsit 2010, paragrafi 19), dhe jo nga frekuenca e situatave të tilla (*Miller kundër Suedisë*, nr. 55853/00, aktgjykim i 8 majit 2005, paragrafi 29; *Mirovni Institut kundër Sllovenisë*, cituar më lart, paragrafi 37).
8. Fakti që seanca dëgjimore nuk mbahet pranë gjykatës së shkallës së dytë ose të tretë mund të justifikohet nga rrethanat e veçanta të procedurës në fjalë nëse seanca është mbajtur në shkallë të parë (*Helmers kundër Suedisë*, nr. 11826/85, aktgjykim i 29 tetorit 1991 godine, paragrafi 36, por, në kontrast me këtë, shih paragrafët 38-39; *Salomonsson kundër Suedisë*, nr. 38978/97, aktgjykim i 12 shkurtit 2003, paragrafi 36). Në këtë mënyrë, procedurat në të cilat vendosin lidhur me një kërkesë për parashtrim të ankesës dhe procedurat që përfshijnë vetëm çështje të ligjit, për dallim prej procedurave për çështje faktike, mund të plotësojnë kërkesat e nenit 6 edhe nëse parashtruesit të kërkesës nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej personalisht nga gjykata e apelit ose e kasacionit (*Miller kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafi 30). Prandaj, duhet pasur parasysh karakteristikat e veçanta të procedurave të zhvilluara pranë gjykatave më të larta.
9. GJEDNJ shqyrtoi nëse mungesa e një seance dëgjimore publike në një nivel më të ulët mund të korrigjohet duke mbajtur një seancë dëgjimore publike në fazën e apelit. Në një sërë rastesh është konstatuar se fakti që procedurat pranë gjykatës së apelit janë zhvilluar në mënyrë publike nuk mund të korrigjojë faktin se nuk ka pasur dëgjim publik në nivelet më të ulëta të juridiksionit kur vëllimi i procedurës ankimore është i kufizuar, veçanërisht kur gjykata e apelit nuk mund të shqyrtojë vetë meritat e vetë rastit, që do të përfshinte shqyrtimin e fakteve dhe vlerësimin nëse dënimi i shqiptuar

ishte në proporcion me veprën penale. Megjithatë, nëse gjykata e apelit ka juridiksion të plotë, atëherë dështimi për të pasur një seancë publike në një nivel më të ulët të juridiksionit të gjykatës mund të korrigjohet përpara asaj gjykate (*Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], cituar më lart, para. 192 dhe referencat e praktikës gjyqësore të përmendura aty). Si rezultat, ankesa në lidhje me mungesën e një seance dëgjimore publike mund të lidhet ngushtë me ankesën në lidhje me qëllimin e pretenduar të pamjaftueshëm të shqyrtimit të kryer nga organi i apelit (ibid, para. 193).

10. GJEDNJ-ja thekson rëndësinë e procedurës akuzuese përpara një organi që shqyrton në mënyrë gjyqësore një vendim që nuk është marrë në pajtim me garancitë e nenit 6, kur ai organ ka për detyrë të përcaktojë nëse baza faktike e vendimit ishte e mjaftueshme për të justifikuar atë (*Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], cituar më lart, paragrafi 211). Në atë rast konkret, fakti që nuk ka pasur seancë dëgjimore as në fazën e nxjerrjes së vendimit disiplinor dhe as në fazën e shqyrtimit gjyqësor, në kombinim me shqyrtimin e pamjaftueshëm gjyqësor, ka sjellë shkeljen e nenit 6, paragrafi 1 (paragrafi 214).
11. Prandaj, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që justifikojnë heqjen dorë nga seanca dëgjimore, (shih përmbledhjen e praktikës gjyqësore të cituar në aktgjykimin e *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], cituar më lart, paragrafi 190), e drejta për një seancë dëgjimore publike sipas nenit 6 paragrafi 1 nënkupton të drejtën për një seancë dëgjimore gojore të paktën në një nivel juridiksioni (*Fischer kundër Austrisë*, nr. 16922/90, aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44; *Salomonsson kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafi 36).
12. Në rastin *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* [DHM], nr. 63235/00, aktgjykim i 19 prillit 2007, paragrafi 74, GJEDNJ konstatoi se nuk ishte shkelur neni 6 paragrafi 1 për shkak se nuk është mbajtur një seancë dëgjimore. Gjykata vlerësoi se është fakt i rëndësishëm që parashtruesit e kërkesës mund të kërkonin seancë dëgjimore edhe pse vendimi për nevojën që ajo të mbahej ishte brenda juridiksionit të gjykatës; ajo gjithashtu konstatoi se gjykatat kishin deklaruar pse refuzuan të mbajnë një seancë; përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kishin mundësi të mjaftueshme për të paraqitur rastin e tyre me shkrim dhe për të komentuar parashtrësit e paraqitura nga pala tjetër në kontest (ibid). Për rastin në të cilin gjykata nxori një aktvendim për masat e përkohshme pa mbajtur seancë dëgjimore, shih *Helmut Blum kundër Austrisë*, nr. 33060/10, aktgjykim i 5 prillit 2016, paragrafët 70–74.
13. Në disa raste mund të jetë gjithashtu legjitime që autoritetet vendase të marrin parasysh efikasitetin dhe ekonominë e procedurës (*Eker kundër Turqisë*, nr. 24016/05, aktgjykim i 24 janarit 2018, paragrafi 29). Në rastin e sipërpërmendur, GJEDNJ-ja nuk kontestoi se procedura gjyqësore në dy nivele të juridiksionit u zhvillua pa seancë dëgjimore. GJEDNJ-ja theksoi se çështjet ligjore nuk ishin veçanërisht të komplikuar dhe se procedura të kryhet pa vonesë (paragrafi 31). Ai kontest kishte të bënte me çështje tekstuale dhe teknike për të cilat ishte e mundur të merrej një vendim i duhur bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës. Përveç kësaj, procedura përfshinte një procedurë jashtëzakonisht urgjente (kërkesë për lëshimin e urdhrit për publikimin e përgjigjes në gazetë), të cilën GJEDNJ e konsideroi të nevojshme dhe të justifikuar në interes të funksionimit të mirë të shtypit.
14. Duhet theksuar se në kontekstin e procedurave disiplinore, duke marrë parasysh se për çfarë bëhet fjalë në këto raste - ndikimi i një dënimi të mundshëm në jetën dhe karrierën e personave në fjalë dhe implikimet financiare të këtyre dënimeve - GJEDNJ është e mendimi se heqja dorë nga seanca dëgjimore duhet të përbëjë një masë të jashtëzakonshme dhe duhet të arsyetohet dhe shpjegohet siç duhet në dritën e

praktikës gjyqësore të saj (*Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], cituar më lart, paragrafët 208–211). Rasti i lartpërmendur është gjithashtu i rëndësishëm kur bëhet fjalë për sanksionet disiplinore të shqiptuara ndaj një gjyqtari. GJEDNJ-ja theksoi veçanërisht kontekstin specifik të procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve (paragrafët 196, 211 dhe 214).

15. Kur bëhet fjalë për procedurat në lidhje me të burgosurit, thjesht fakti që ata janë në burg nuk mund të shërbejë si justifikim për heqjen dorë nga seanca dëgjimore para një gjykate civile (*Igranov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 42399/13 dhe 8 të tjerë, aktgjykim i 10 shtatorit 2018, paragrafët 34–35). Mund të merren parasysh arsyet praktike, por duhet të respektohen parimet e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe i burgosuri duhet të jetë në gjendje të kërkojë të jetë i pranishëm në seancë (*Altay kundër Turqisë* (nr. 2), nr. 11236/09, aktgjykim i 9 korrikut 2019, paragrafi 77). Nëse i burgosuri nuk ka paraqitur një kërkesë të tillë kur një mundësi e tillë nuk parashikohet në legjislacionin e brendshëm, kjo nuk do të thotë se i burgosuri ka hequr dorë nga e drejta për t'u paraqitur në gjykatë (paragrafi 78). Në këtë kontekst, pyetja e parë në të cilën duhet përgjigjur është nëse natyra e kontestit është e tillë që kërkon që i burgosuri të paraqitet personalisht në seancë. Nëse po, atëherë autoriteteve vendase u kërkohet të marrin masa praktike të një natyre procedurale për të siguruar pjesëmarrjen efektive të të burgosurit në seancën dëgjimore dhe rastin e tij (*Yevdokimov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 27236/05, 44223/05, 53304/07, 40232/11, 60052/11, 76438/11, 14919/12, 19929/12, 42389/12, 57043/12 dhe 67481/12, aktgjykim i 16 majit 2016, paragrafët 33–47). Në rastin e sipërpërmendur, gjykatat vendase refuzuan t'i lejonin të burgosurit të merrnin pjesë në seancat e procedurave civile në të cilat ata ishin palë në kontest, me arsyetimin se legjislacioni vendas nuk parashikon mundësinë e transportimit të të burgosurve në gjykatë. GJEDNJ-ja konstatoi se parashtruesve të kërkesës iu ishte mohuar mundësia për të paraqitur në mënyrë efektive rastet e tyre dhe konstatoi se autoritetet vendase kishin shpërfillur detyrimin e tyre për të garantuar respektimin e parimit të një gjykimi të drejtë (para. 52 – shih gjithashtu *Altay kundër Turqisë* (nr. 2), cituar më lart, paragrafët 78–81). Përveç kësaj, problemi praktik që lind nga fakti që parashtruesi i kërkesës është duke vuajtur dënimin me burg në një vend tjetër nuk është pengesë për të shqyrtuar disa mundësi të tjera procedurale, siç janë aplikimi i teknologjive moderne të komunikimit, për të respektuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar në gjykatë (*Pönkä kundër Estonisë*, nr. 64160/11, aktgjykim i 8 shkurtit 2017, paragrafi 39).
16. Në rastin *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], cituar më lart, Dhoma e Madhe përmbledhi disa shembuj të situatave kur një seancë dëgjimore ishte ose nuk ishte e nevojshme (paragrafët 190–191).
17. 381. Shembuj konkret:
 - a) Seanca dëgjimore nuk është e nevojshme kur nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuarra për të cilat do të ishte e nevojshme të mbahej një seancë dëgjimore dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim (*Döry kundër Suedisë*, nr. 28394/95, aktgjykim i 12 shkurtit 2003, paragrafi 37; *Saccoccia kundër Austrisë*, nr. 69917/01, aktgjykim i 4 majit 2009, paragrafi 73; *Mirovni Institut kundër Sllovenisë*, cituar më lart, paragrafi 37).
 - b) GJEDNJ-ja ka pranuar gjithashtu se heqja dorë nga seanca dëgjimore mund të justifikohet në rastet kur ngrihen vetëm çështje juridike të cilat janë të kufizuara për nga natyra (*Allan Jacobsson kundër Suedisë* (nr. 2), cituar më lart, paragrafi 49; *Valová, Slezák dhe Slezák kundër Sllovakisë*, nr. 44925/98, aktgjykim i 1

shtatorit 2004, paragrafët 65–68) ose ato raste që nuk janë veçanërisht komplekse (*Varela Assalino kundër Portugalisë*, nr. 64336/01, vendim i 25 prillit 2002 (vend.); *Speil kundër Austrisë*, nr. 42057/98, vendimi (dec.). E njëjta gjë vlen edhe për pyetjet shumë të specializuara. GJEDNJ ka marrë parasysh teknikën, përkatësisht natyrën profesionale të kontesteve për kompensimet e sigurimeve sociale, të cilat zgjidhen më mirë me shkrim sesa në seancat dëgjimore. Në disa raste, GJEDNJ-ja ka mbrojtur qëndrimin se autoritetet kombëtare në atë sferë, duke marrë parasysh kërkesat e vendosura në aspektin e efikasitetit dhe ekonomisë, mund të përmbahen nga mbajtja e seancave dëgjimore, pasi mbajtja sistematike e seancave mund të rrezikojë vëmendjen dhe kujdesin e veçantë që duhet të manifestohet në procedurat e sigurimeve sociale (*Schuler-Zraggen kundër Zvicrës*, nr. 14518/89, aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 58; *Döry kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafi 41; përkundër kësaj, shih *Salomonsson kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafët 39–40). Në aktgjykimin në rastin *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë [DHM]*, cituar më lart specifikoi se pavarësisht nga natyra teknike e disa diskutimeve dhe në varësi të asaj se për çfarë rasti bëhet fjalë, mbikëqyrja publike duhet parë si një kusht i domosdoshëm si në aspektin e transparencës ashtu edhe në aspektin për mbrojtjen e të drejtave të palëve në kontest (paragrafët 208 dhe 210).

- c) Në kundërshtim me këtë, mbajtja e një seance dëgjimore konsiderohet e nevojshme kur, për shembull, duhet të shqyrtohen çështjet e ligjit dhe çështjet e rëndësishme faktike (*Fischer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 44) ose kur është e nevojshme të vlerësohet nëse autoritetet i kanë vërtetuar saktë faktet (*Malhous kundër Republikës Çeke [DHM]*, cituar më lart, paragrafi 60) dhe kur është e nevojshme të sigurohet që faktet përkatëse të shqyrtohen më në detaje (*Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë [DHM]*, cituar më lart, paragrafi 211), si dhe kur rrethanat kërkojnë që gjykatat të marrin një përshtypje personale lidhur me parashtruesin e kërkesës, kur parashtruesit të kërkesës duhet t'i mundësohet të shpjegojë pozitën e tij në të cilën gjendet, duke e bërë këtë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor Udhëzuesi për nenin 6 të Konventës - E drejta për një gjykim të drejtë (aspekti civil) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut 74/97 Përditësimi i fundit: 31 gusht 2019 (*Miller kundër Suedisë*, cituar më lart, paragrafi 34 in fine; *Andersson kundër Suedisë*, nr.17202/04, aktgjykim i 7 marsit 2011, paragrafi 57) – për shembull kur gjykata duhet të dëgjojë dëshminë e parashtruesit të kërkesës rreth vuajtjes personale që ka përjetuar për të qenë në gjendje të përcaktojë nivelin e kompensimit që do të jepet (*Göç kundër Turqisë [DHM]*, cituar më lart, paragrafi 51; *Lorenzetti kundër Italisë*, paragrafi 33) ose kur gjykata duhet të marrë informata në lidhje me karakterin e parashtruesit të kërkesës, sjelljen e tij dhe rrezikun që ai përfaqëson (*De Tommaso kundër Italisë [DHM]*, cituar më art, paragrafi 167) – ose kur gjykata kërkon sqarime në disa pika, ndër të tjera dhe në këtë mënyrë (*Fredin kundër Suedisë* (nr. 2), cituar më lart, paragrafi 22; *Lundevall kundër Suedisë*, nr. 38629/97, aktgjykim i 12 shkurtit 2003, paragrafi 39)
18. Në rastin e GJEDNJ-së, *Pönkä kundër Estonisë* që ndërlidhej me zhvillimin e një procedure të thjeshtuar (e rezervuar për padi te vogla) dhe në lidhje me vendimin e gjykatës për të mos mbajtur seancën dëgjimore, dhe gjykata nuk deklaroi pse e zbatoi procedurën me shkrim (paragrafët 37–40). Në rastin *Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë*, bëhej fjalë për kontestimin e vendimit për refuzimin e ofertës në procedurën e konkursit publik (procedura e tenderit). Gjykata e brendshme nuk dha asnjë arsytim për refuzimin e saj për të mbajtur një seancë dëgjimore, gjë që e bëri të pamundur për Gjykatën në Strasburg të përcaktojë nëse gjykata e brendshme thjesht ka neglizhuar shqyrtimin e kërkesës për një seancë dëgjimore nga Instituti, i cili ka paraqitur

kërkesën, ose vendosi ta refuzojë atë kërkesë dhe, nëse po, për çfarë arsye (paragrafi 44). Në të dyja rastet, GJEDNJ konstatoi se duke refuzuar mbajtjen e seancës dëgjimore, ishte shkelur neni 6, paragrafi 1 (Pönkä kundër Estonisë, cituar më lart, paragrafi 40; Mirovni Inštitut kundër Sllovenisë, cituar më lart, paragrafi 45).

19. Në rastin në lidhje me një seancë dëgjimore para Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (CAS), GJEDNJ konstatoi se çështjet në lidhje me çështjen nëse dënimi i vendosur ndaj parashtruesit dhe parashtrueses së kërkesës për doping ishte i justifikuar kërkojnë që të mbahet një seancë e hapur, e cila do t'i mundësojë pasqyrë publikut. GJEDNJ-ja vuri në dukje se faktet e kontestuara në kërkesë dhe dënimin që i kërcënohej mbartin një shkallë të lartë të stigmatizimit dhe mundësisë për të pasur ndikim negativ në nderin profesional të parashtrueses së kërkesës. Për këto arsye, GJEDNJ konkludoi se kishte pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1, për shkak të mosmbajtjes së seancë publike para CAS-it (Mutu dhe Pechstein kundër Zvirisë, nr. 40575/10 i 67474/10, aktgjykim i 4 shkurtit 2019, paragrafët 182-183).
20. Sa herë që mbahet një seancë publike, palët kanë të drejtë të marrin pjesë në seancë dhe të paraqesin prova gojore ose të zgjedhin një mënyrë tjetër për të marrë pjesë në procedurë (për shembull duke caktuar përfaqësuesit e tyre ligjorë) ose të kërkojnë shtyrjen e procedurës. Për të ushtruar në mënyrë efektive këto të drejta, palët në kontest duhet të njoftohen për datën dhe orën e seancës mjaftueshëm para seancës për t'u mundësuar atyre përgatitjen. GJEDNJ njoftoi se gjykatat vendase, para se të vazhdojnë shqyrtimin për meritat e rastit, janë të detyruara të kontrollojnë nëse palët kanë qenë të njoftuara siç duhet për mbajtjen e seancës. Analiza e paraqitur në vendimet e gjykatave vendase duhet të përmbajë më shumë se një përmendje të thjeshtë se është lëshuar një ftesë dhe duhet të përdorë sa më mirë provat në dispozicion për të përcaktuar nëse pala që nuk u paraqit në seancë ishte vërtet e njoftuar mjaftueshëm përpara seancës. Dështimi i gjykatës vendase për të kontrolluar nëse pala që nuk u paraqit në seancë ishte njoftuar me kohë për këtë dhe, nëse jo, nëse seanca duhet të shtyhej, është në vetvete e papajtueshme me respektimin e vërtetë të parimit të një gjykimi të drejtë dhe GJEDNJ-ja mund të konstatojë se ishte shkelur neni 6, paragrafi 1 (shih Gankin dhe të tjerët kundër Rusisë, nr. 2430/06, 1454/08, 11670/10 dhe 12938/12, aktgjykim i 31 gushtit 2016, paragrafët 39 dhe 42, me një përmbledhje të parimeve të vendosura në praktikën gjyqësore lidhur me njoftimin në kohë të seancave, dhënien e informatave palëve dhe çështjen e heqjes dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore, paragrafët 34-38).
21. Prania e medieve dhe e publikut: Karakteri publik i seancës para organeve gjyqësore u siguron palëve në kontest mbrojtje nga zhvillimi i procedurës së mbyllur, pa kontroll publik dhe në këtë kuptim është një nga mënyrat për të ruajtur besimin e publikut në gjykata, gjë që kontribuon në arritjen e qëllimit të një gjykimi të drejtë (Diennet kundër Francës, nr. 18160/91, aktgjykim i 26 shtatorit 1995, paragrafi 33; Martinie kundër Francës [DHM], nr. 58675/00, aktgjykim i 12 prillit 2006, paragrafi 39; Gautrin dhe të tjerët kundër Francës, nr. 38/1997/822/1025-1028, aktgjykim i 20 majit 1998, paragrafi 42; Hurter kundër Zvicrës, nr. 53146/99, aktgjykim i 14 marsit 2006, paragrafi 26; Lorenzetti kundër Italisë, nr. 32075/09, aktgjykim i 10 korrikut 2012, paragrafi 30. Megjithatë, neni 6 paragrafi 1 nuk i ndalon gjykatat të devijojnë nga ai parim në dritën e rrethanave të veçanta të rastit (Martinie kundër Francës [DHM], cituar më lart, paragrafët 40-44). Mbajtja e procedurës, tërësisht ose pjesërisht, me dyer të mbyllura duhet të kushtëzohet rreptësisht nga rrethanat e rastit (Lorenzetti kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 30). Formulimi në tekstin e nenit 6, paragrafi 1, mundëson disa përjashtime.
22. Sipas tekstit të nenit 6, paragrafi 1, "mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij."

- a) “Në interes të moralit, rendit publik apo sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike” (Zagorodnikov kundër Rusisë, nr. 66941/01, aktgjykim i 7 shtatorit 2007, paragrafi 26; B. dhe P. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 36337/97 dhe 35974/97, aktgjykim i 5 shtatorit 2001, paragrafi 39); Udhëzues për nenin 6 të Konventës - E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut 75/97 Përditësimi i fundit: 31 gusht 2019.
 - b) “kur kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve”: interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve bëhet, për shembull, në procedurat lidhur me vendbanimin e të miturve. pas diskutimeve ndërmjet prindërve ose në kontestet ndërmjet anëtarëve të së njëjtës familje (ibid, paragrafi 38); por në rastet që përfshijnë vendosjen e një fëmije në një institucion publik, arsyet për përjashtimin e publikut nga procedura duhet të shqyrtohen me shumë kujdes (Moser kundër Austrisë, nr. 12643/02, aktgjykim i 21 dhjetor 2006, paragrafi 97). Kur bëhet fjalë për procedurën disiplinore kundër një mjeku, megjithëse nevoja për të ruajtur sekretin profesional dhe jetën private të pacientit mund të justifikojë procedurat që zhvillohen pa praninë e publikut, megjithatë kjo duhet të justifikohet shprehimisht nga rrethanat (Diennet kundër Francës, cituar më lart, paragrafi 34; për shembull procedurës kundër avokatit, shih Hurter kundër Zvicrës, cituar më lart, paragrafi 30–32);
 - c) “ose në masën që, sipas mendimit të gjykatës, është e nevojshme në rrethana të veçanta dhe kur publiku mund të dëmtojë interesat e drejtësisë”: është e mundur të kufizohet natyra e hapur dhe publike e procesit për të mbrojtur sigurinë dhe privatësinë e dëshmitarëve ose për të inkurajuar dhe përmirësuar shkëmbimin e lirë të informatave dhe opinioneve në ndjekje të drejtësisë (B. dhe P. kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 38; Osinger kundër Austrisë, nr. 54645/00, aktgjykim i 24 qershorit 2005, paragrafi 45)
23. GJEDNJ shtoi se praktika gjyqësore lidhur me mbajtjen e seancave dëgjimore, e cila kryesisht i referohet të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës, e përcaktuar në nenin 6, paragrafi 1 (shih më lart), zbatohet sipas analogjisë për seancat që janë të hapura për publikun. Prandaj, një seancë dëgjimore e mbajtur në përputhje me ligjin e brendshëm, në parim, duhet të jetë publike. Megjithatë, detyrimi për të mbajtur një seancë publike nuk është absolut, pasi rrethanat që mund të justifikojnë mungesën e tij varen në thelb nga natyra e çështjeve që do të përcaktohen nga gjykatat e brendshme (De Tommaso kundër Italisë [DHM], cituar më lart, paragrafët 163-67). “Rrethanat e jashtëzakonshme - duke përfshirë natyrën shumë të specializuar të çështjeve që do të vendosen - mund të justifikojnë mungesën e një seance dëgjimore publike nëse objekti specifik i kontestit nuk është i tillë që të kërkojë shqyrtim publik” (Lorenzetti kundër Italisë, cituar më lart, paragrafi 32).
 24. Vetëm prania e informatave konfidenciale në shkresat e lëndës nuk nënkupton automatikisht nevojën e mbylljes së seancës për publikun. Prandaj, para se të përjashtohet publiku nga një procedurë e caktuar, gjykatat duhet të shqyrtojnë në mënyrë specifike nëse një përjashtim i tillë është i nevojshëm për mbrojtjen e interesit publik dhe duhet të kufizojnë masën vetëm në atë që është shprehimisht e nevojshme për të arritur qëllimin e ndjekur (Nikolova dhe Vandova kundër Bullgarisë, nr. 31195/96, aktgjykim i 25 marsit 1999, paragrafët 74–77, ku seanca u mbajt me dyer të mbyllura për shkak të dokumenteve që ishin klasifikuar si sekret shtetëror).
 25. Në fund, mungesa e seancës dëgjimore mund ose nuk mund të korrigjohet në një fazë të mëvonshme të procedurës (Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, nr. 6878/75; 7238/75, aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafët 60–61;

Diennet kundër Francës, cituar më lart, paragrafi 34; Malhous kundër Republikës Çeke [DHM], cituar më lart, paragrafi 62).

26. Heqja dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore publike: as shkronja dhe as fryma e nenit 6 paragrafi 1 nuk e pengojnë një individ që të heqë dorë vullnetarisht nga e drejta e tij për një seancë dëgjimore publike, shprehimisht ose në heshtje, por një heqje dorë duhet të jetë e qartë dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me çdo interes të rëndësishëm publik (Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, cituar më lart, paragrafi 59; Håkansson dhe Stureson kundër Suedisë, nr. 11855/85, cituar më lart, 21 shkurt 1990, paragrafi 66; Exel kundër Republikës Çeke, nr. 48962/99, aktgjykim i 5 tetorit 2005, paragrafi 46. Ftesa për seancë duhet të merret gjithashtu me kohë (Yakovlev kundër Rusisë, nr. 72701/01, aktgjykim i 15 marsit 2005, paragrafët 20–22).
27. Kushtet që rregullojnë heqjen dorë nga këto të drejta: personi në fjalë duhet të japë pëlqimin për të (Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, cituar më lart, paragrafi 59), dhe në bazë të vullnetit të tij të lirë (Albert i Le Compte kundër Belgjikës, nr. 7299/75; 7496/76, aktgjykim i 10 shkurtit 1983, paragrafi 35). Kjo e drejtë mund të hiqet shprehimisht ose në heshtje (LeCompte, Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, cituar më lart, paragrafi 59). Megjithatë, kjo duhet të bëhet në mënyrë të paqartë (Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, cituar më lart, paragrafi 35; Håkansson dhe Stureson kundër Suedisë, cituar më lart, paragrafi 67) dhe nuk duhet të bie ndesh me ndonjë interes të rëndësishëm publik (ibid, paragrafi 66).
28. Nëse një person nuk kërkon mbajtjen e seancës dëgjimore publike, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se personi në fjalë ka hequr dorë nga e drejta për dëgjim publik; duhet të merret parasysh ligji vendas i zbatueshëm (Exel kundër Republikës Çeke, cituar më lart, paragrafi 47; Göç kundër Turqisë [DHM], cituar më lart, paragrafi 48 in fine). Nuk ka rëndësi nëse parashtruesi i kërkesës ka kërkuar një seancë dëgjimore publike apo jo nëse ligji vendas i zbatueshëm e përjashton shprehimisht një mundësi të tillë (Eisenstecken kundër Austrisë, nr. 29477/95, aktgjykim i 3 tetorit 2000, paragrafi 33).
29. Shembuj: heqja dorë nga e drejta për një seancë dëgjimore publike në procedurë disiplinore: Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës, cituar më lart, paragrafi 59; H. kundër Belgjikës, paragrafi 54. Heqja dorë pa mëdyshje nga e drejta për një seancë publike: Schuler-Zraggen kundër Zvicrës, cituar më lart, paragrafi 58; në të kundërtën, shih Exel kundër Republikës Çeke, cituar më lart, paragrafët 48–53.

(IV) Rastet në të cilat GJEDNJ arsyetoi se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca dëgjimore

30. Duke theksuar parimet e përgjithshme të së drejtës për një seancë dëgjimore në seksionin e mësipërm, unë kam përmendur të gjitha parimet e përgjithshme të përcaktuara nga GJEDNJ në manualet dhe udhëzuesit e saj për zbatimin e nenit 6 të KEDNJ-së, dhe përfundimi i përgjithshëm është se e drejta për dëgjim publik është një rregull që vuan disa përjashtime.
31. Për nevoja të mëtejshme të analizës së rastit specifik, do të shtjelloj përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm dhe do t'i zbatoj ato në një rast specifik.
32. Rikujtoj se GJEDNJ në Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë [DHM], cituar më lart, Dhoma e Madhe përmbledhi disa shembuj të situatave në të cilat një seancë dëgjimore ishte ose nuk ishte e nevojshme (paragrafët 190–191).

33. Shembuj konkret:

- a) Seanca nuk është e nevojshme kur nuk ka çështje besueshmërie dhe kur nuk ka fakte të kontestuara që do të kërkonin seancë, dhe gjykatat mund të marrin një vendim të drejtë dhe të arsyetuar për çështjen në bazë të parashtresave të palëve dhe materialeve të tjera në formë të shkruar (Döry kundër Suedisë, paragrafi 37; Saccoccia kundër Austrisë, cituar më lart, paragrafi 73; Mirovni Institut kundër Sllovenisë, cituar më lart, paragrafi 37).
- b) GJEDNJ-ja ka pranuar gjithashtu se heqja dorë nga seanca dëgjimore mund të justifikohet në rastet kur ngrihen vetëm çështje juridike të cilat janë të kufizuara për nga natyra (Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), cituar më lart, paragrafi 49; Valová, Slezák dhe Slezák kundër Sllovakisë, cituar më lart, paragrafët 65–68) ose ato raste që nuk janë veçanërisht komplekse (Varela Assalino kundër Portugalisë (vendim), cituar më lart; Speil kundër Austrisë (vendim), cituar më lart. E njëjta gjë vlen edhe për çështjet shumë të specializuara. GJEDNJ ka marrë parasysh teknikën, përkatësisht natyrën profesionale të kontesteve për kompensimet e sigurimeve sociale, të cilat zgjidhen më mirë me shkrim sesa në seancat dëgjimore. Në disa raste, GJEDNJ-ja ka mbrojtur qëndrimin se autoritetet kombëtare në atë sferë, duke marrë parasysh kërkesat e vendosura në aspektin e efikasitetit dhe ekonomisë, mund të përmbahen nga mbajtja e seancave dëgjimore, pasi mbajtja sistematike e seancave mund të rrezikojë vëmendjen dhe kujdesin e veçantë që duhet të manifestohet në procedurat e sigurimeve sociale (Schuler Zraggen kundër Zvicrës, cituar më lart, paragrafi 58; Döry kundër Zvicrës, cituar më lart, paragrafi 41; përkundër kësaj, shih Salomonsson kundër Zvicrës, cituar më lart, paragrafët 39–40). Në aktgjykimin në rastin Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë [DHM], cituar më lart, specifikoi se pavarësisht nga natyra teknike e disa diskutimeve dhe në varësi të asaj se për çfarë rasti bëhet fjalë, mbikëqyrja publike duhet parë si një kusht i domosdoshëm si në aspektin e transparencës ashtu edhe në aspektin për mbrojtjen e të drejtave të palëve në kontest (paragrafët 208 dhe 210).
34. Fillimisht, GJEDNJ në rastin Döry kundër Suedisë, paragrafët 37–45, arriti në përfundimin se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca dëgjimore në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke shpjeguar në detaje;

37. Gjykata fillimisht arrin në përfundimin se e drejta për “dëgjim publik” në nenin 6, paragrafi 1 nënkupton domosdoshmërisht të drejtën për “dëgjim me gojë”. Megjithatë, detyrimi sipas nenit 6 paragrafi 1 për të mbajtur një seancë publike nuk është absolut. Prandaj, nga seanca mund të hiqet dorë nëse pala heq dorë pa mëdyshje nga e drejta e saj për ta bërë këtë dhe nuk ka çështje me interes publik që e bëjnë të nevojshme seancën. Heqja dorë mund të bëhet në mënyrë eksplicite ose të heshtur, në rastin e fundit, për shembull, duke u përmbajtur nga paraqitja ose mbajtja e një kërkesë për një seancë dëgjimore (shih, midis autoriteteve të tjera, Hakanesson dhe Sturesson kundër Suedisë, nr. 11855/85, aktgjykim i 21 shkurtit 1990, Seria A nr. 171-A, f. 20, paragrafi 66 dhe Schuler-Zraggen kundër Zvicrës, aktgjykimi i 24 qershorit 1993, Seria A nr. 263, f. 19–20, paragrafi 58). Për më tepër, një seancë dëgjimore mund të mos jetë e nevojshme për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme të çështjes, për shembull kur nuk lindin çështje faktike ose juridike të cilat nuk mund të zgjidhen në mënyrë adekuate në bazë të shkresave të lëndës dhe parashtresave me shkrim të palëve (shih, mutatis mutandis, Fredin kundër Suedisë (nr. 2), nr. 18928/91 Aktgjykimi i 23 shkurtit 1994, Seria A Nr. 283-A, f. A Nr. 312, f. 20–21, paragrafi 44).

38. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk kërkoj seancë dëgjimore në Gjykatën Administrative të Qarkut në asnjë nga rastet e saj. Megjithatë, neni 9 i Ligjit të vitit 1971 parashikonte që procedurat para gjykatave administrative do të kryheshin normalisht me shkrim, mund të pritej nga parashtruesja e kërkesës të kërkonte një seancë dëgjimore përpara asaj gjykate nëse i kushtonte rëndësi. Megjithatë, ajo nuk e bëri këtë dhe për rrjedhojë Gjykata konstaton se me arsye mund të konsiderohet se ajo ka hequr dorë nga e drejta e saj për një seancë dëgjimore në Gjykatën Administrative të Qarkut. Për më tepër, Gjykata Supreme e Sigurimeve Sociale thjesht përcaktoi nëse do ta lejonte apo jo ankesën dhe, si pasojë e refuzimit të saj për të aprovuar mungesën, nuk e shqyrtoi plotësisht rastin e parashtruesit të kërkesës. Edhe duke supozuar se neni 6, paragrafi 1, zbatohet për zgjidhjen e kësaj çështjeje, Gjykata konstaton se ajo mund të zgjidhet në mënyrë adekuate në bazë të shkresave të lëndës dhe parashtrësive me shkrim dhe se, në pajtim me këtë, u justifikua mungesa e seancës gojore para Gjykatës Supreme të Sigurimeve Sociale.

39. Mbetet për t'u përcaktuar nëse mungesa e një seance dëgjimore pranë Gjykatës Administrative të Apelit paraqet shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës sipas nenit 6 paragrafi 1. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se në procedurën para gjykatës së parë dhe të vetme për shembull, zakonisht ekziston e drejta për një seancë dëgjimore (shih, ndër të tjera, Hakansson dhe Stureson kundër Suedisë, aktgjykimi i cituar më lart, f. 20, paragrafi 64). Megjithatë, mungesa e seancës para shkallës së dytë ose të tretë mund të justifikohet nga veçoritë e procedurës kontestimore, me kusht që një seancë dëgjimore të jetë mbajtur në shkallën e parë (shih, për shembull, Helmers kundër Suedisë, nr. 11826/85, aktgjykim i 29 tetorit 1991, Seria A nr 212-A, f. 16, paragrafi 36). Rrjedhimisht, nëse nuk ekzistojnë rrethanat të jashtëzakonshme që arsyetojnë heqjen dorë nga seanca dëgjimore, e drejta për seancë publike sipas nenit 6 paragrafi 1 nënkupton të drejtën për një seancë gojore para së paku një instance.

40. Gjykata vëren se nuk u mbajt asnjë seancë dëgjimore në shkallën e parë sepse parashtruesja e kërkesës nuk i kërkoj Gjykatës Administrative të Qarkut ta mbajë atë. Ajo pranon se, në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, zakonisht është më e përshtatshme që seanca të zhvillohet në shkallë të parë dhe jo vetëm përpara gjykatës së apelit. Prandaj, në varësi të rrethanave të rastit, mund të jetë e pranueshme që kërkesa për seancë dëgjimore të refuzohet sipas ankesës, edhe pse nuk është mbajtur një seancë e tillë në shkallën e parë.

41. Gjykata pranon më tej se kontestet në lidhje me përfitimet sipas skemave të sigurimeve sociale janë përgjithësisht mjaft teknike dhe rezultati i tyre zakonisht varet nga mendimet mjekësore me shkrim. Prandaj, shumë konteste të tilla mund të zgjidhen më mirë me argumente me shkrim dhe jo me gojë. Për më tepër, është e kuptueshme që në këtë sferë autoritetet kombëtare duhet të kenë parasysh kërkesat e efikasitetit dhe ekonomisë. Mbajtja sistematike e seancave dëgjimore mund të përbëjë një pengesë për kujdesin e veçantë që kërkohet në rastet e sigurimeve sociale (shih Schuler-Zraggen kundër Zvicrës, aktgjykimi i cituar më lart, f. 19-20, paragrafi 58).

42. Në rastet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se juridiksioni i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ishte i kufizuar në çështje ligjore, por shtrihej edhe në çështje faktike. Çështja në të dyja rastet ishte nëse aftësia e parashtrueses së kërkesës për punë ishte zvogëluar në mënyrë të tillë që t'i jepte asaj të drejtën për përfitime sipas ligjeve të 1962 dhe 1976. Gjykata vëren, megjithatë, se vlerësimet e gjykatave bazoheshin tërësisht në provat mjekësore të rasteve, të paraqitura në formën e opinionëve me shkrim të dhëna nga mjekë të ndryshëm. Nuk duket se

mendimet e mjekëve kanë dalluar. Parashtruesja e kërkesës iu referua edhe kësaj prove me shkrim; në ankesën e saj ndaj vendimit të Zyrës të datës 20 nëntor 1991, ajo argumentoi se mendimet mjekësore në fakt tregonin se ajo kishte të drejtë në përfitimet e kërkuara.

43. Në këto rrethana, duhet të konkludohet se kontesti në rastet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Administrative të Apelit, kishte të bënte me interpretimin e duhur të provave mjekësore me shkrim. Gjykata vlerëson se gjykata e apelit mund ta zgjidhte në mënyrë adekuate këtë çështje bazuar në certifikatat përkatëse mjekësore dhe parashtruesat me shkrim të parashtruesit të kërkesës. Në lidhje me këtë, ajo vëren se parashtruesja e kërkesës, në vendimet për refuzimin e kërkesave të saj për seancë gojore, është ftuar nga gjykata e apelit të paraqesë vërejtjet përfundimtare me shkrim.

44. Gjykata merr parasysh më tej se parashtruesja e kërkesës nuk i kërkoj Gjykatës Administrative të Apelit të thërriste dëshmitarë dhe nuk u mbështet në asnjë provë tjetër gojore. Në të vërtetë, ajo nuk ka deklaruar arsyet e kërkesave të saj që gjykata e apelit të mbajë seanca dëgjimore për rastet.

45. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se kanë ekzistuar rrethanat e jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca në rastet e parashtrueses së kërkesës. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës.

35. Më pas GJEDNJ në rastin Saccoccia kundër Austrisë, paragrafët 73-80, arriti në përfundimin se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seancat dëgjimore në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar në detaje;

73. Prandaj, gjykata duhet të shqyrtojë nëse ekzistojnë rrethana të një natyre të tillë që të përjashtojnë gjykatat nga mbajtja e seancës dëgjimore. Gjykata pranoi se një seancë dëgjimore mund të mos kërkohet nëse nuk ka çështje të besueshmërisë ose fakte të kontestueshme që kërkojnë dëgjim dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme çështjen në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim (shih, si autoritet i fundit, *mutatis mutandis*, Jussila kundër Finlandës [DHM], nr. 73053/01, paragrafi 41, GJEDNJ 2006-KSIV, me referenca të mëtejshme).

74. Nga praktika gjyqësore e Gjykatës, rezulton se natyra e rrethanave që mund të justifikojnë heqjen dorë nga seanca gojore në thelb reduktohet në natyrën e çështjeve të vendosura nga gjykata kombëtare kompetente dhe jo në shpeshtësinë e situatave të tilla. Kjo nuk do të thotë se refuzimi për të mbajtur një seancë dëgjimore mund të justifikohet vetëm në raste të rralla (ibid, paragrafi 42). Parimi kryesor i drejtësisë i përfshirë në nenin 6 është, si gjithmonë, një shqyrtim kryesor.

75. Gjykata ka marrë veçanërisht parasysh natyrën teknike të kontesteve për përfitimet e sigurimeve sociale, të cilat zgjidhen më mirë me shkrim sesa me argumente gojore. Ajo ka konsideruar vazhdimisht se në këtë sferë, autoritetet kombëtare, duke pasur parasysh kërkesat e efikasitetit dhe ekonomisë, mund të përmbahen nga mbajtja e seancave dëgjimore, sepse mbajtja sistematike e seancave mund të jetë pengesë për kujdesin e veçantë që kërkohet në procedurat e sigurimeve sociale (shih, për shembull, Schuler-Zraggen kundër Zvicrës, 24 qershor 1993, paragrafi 58, Seria A, nr. 263, Pitkanen kundër Suedisë, nr. numër 52793/99, 26 gusht 2003). Për më tepër, Gjykata ka vërejtur ndonjëherë se

kontesti në fjalë nuk ka ngritur çështje me rëndësi publike, kështu që është e nevojshme një seancë dëgjimore (shih Schuler-Zraggen, ibid).

76. Për më tepër, Gjykata ka pranuar se heqja dorë nga seanca mund të justifikohet në rastet që ngrenë vetëm çështje juridike të një natyre të kufizuar (shih Allan Jacobsson (nr. 2), cituar më lart, para. 48-49, dhe Valova dhe të tjerët kundër Sllovakisë, nr. 44925/98, paragrafi 68, 1 qershor 2004) ose pa kompleksitet të veçantë (Varela Assalino kundër Portugalisë (vendim), nr. 64336/01, 25 prill 2002 dhe Speil kundër Austrisë (vendim) 42057/98, 5 shtator 2002).

77. Duke iu rikthyer rrethanave të këtij rasti, Gjykata vëren se gjykatat duhej të shqyrtonin nëse ishin përmbushur kushtet e përcaktuara në dispozitat përkatëse të ELAA dhe Traktatit të vitit 1998 për ekzekutimin e një urdhri konfiskimi të pronës. Çështjet që do të shqyrtoheshin përfshinin çështjet e reciprocitetit, nëse aktet e kryera nga parashtruesi i kërkesës ishin të dënueshme sipas ligjit austriak në kohën kur u kryen, respektimi i afateve kohore ligjore dhe nëse procedurat pranë Gjykatës së Qarkut të Rhode Island, e cila dha urdhrin për konfiskim, ishte në përputhje me standardet e nenit 6 të Konventës.

78. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo procedurë kishte të bënte më tepër me çështje teknike të bashkëpunimit ndërshtetëror në luftën kundër pastrimit të parave nëpërmjet ekzekutimit të një urdhri konfiskimi të huaj. Ata ngritën vetëm çështje ligjore të një natyre të kufizuar. Gjithçka që gjykatat austriake duhej të përcaktonin ishte nëse kushtet e përcaktuara në ELAA dhe në Traktatin e vitit 1998 për autorizimin e ekzekutimit të një urdhri konfiskimi ishin përmbushur. Siç është përcaktuar tashmë (shih paragrafët 63-64 më lart), procedurat nuk përfshinin një rivlerësim të bazueshmërisë së urdhrit të konfiskimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit të Rhode Island.

79. Kjo procedurë nuk kërkonte dëgjimin e dëshmitarëve apo paraqitjen e provave të tjera gojore. Për më tepër, Gjykata pajtohet me Qeverinë që gjykatat nuk ishin ftuar të dëgjonin personalisht parashtruesin e kërkesës. Procedurat nuk ngritën asnjë çështje për besueshmërinë e tij, as nuk kishin të bënin me ndonjë rrethanë që do t'i kërkonte gjykatave të krijojnë një përshtypje personale për parashtruesin e kërkesës. Në këto rrethana, gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme rastin në bazë të parashtrësive me shkrim të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim. Prandaj, ato u liruan nga mbajtja e seancës dëgjimore.

80. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1.

36. Më tej, në rastin Saccoccia kundër Austrisë, GJEDNJ iu referua rastit (Varela Assalino kundër Portugalisë vendimi nr. 64336/01, i 25 prillit 2002, ku konkludoi se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca dëgjimore në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar në detaje;

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës në parim kishte të drejtën e një dëgjimi publik, pasi asnjë nga përjashtimet e parashikuara në fjalinë e dytë të nenit 6, paragrafi 1. A, f. 20, paragrafi 64). Gjithashtu, ai kërkoj në mënyrë specifike, në Gjykatën e Apelit dhe më pas në Gjykatën Supreme, që të mbahet seanca para gjykatës së shkallës së parë.

Mbetet për t'u parë nëse natyra e çështjeve për të cilat do të vendosej kërkonte mbajtjen e dëgjimeve publike.

Në lidhje me këtë, gjykata rikujton se gjykata e Tomarit vendosi, në të dy procedurat, se gjendja e shkresave të lëndës bëri të mundur shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës pa pasur nevojë për prova shtesë. Në fakt, gjykata vlerësoi se ishin vërtetuar faktet e rastit, kështu që i mbetej të vendosej vetëm për çështjet ligjore në lidhje me interpretimin e dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

Në sytë e Gjykatës, ky përfundim nuk mund të konsiderohet i paarsyeshëm. Në të vërtetë, procedura kontestimore nuk ngritën ndonjë çështje e cila nuk mund të zgjidhej në mënyrë adekuate në bazë të shkresave. Ndryshe nga rasti *Malhous (Malhous kundër Republikës Çeke [DHM], nr. 33071/96, aktgjykimi i 12 korrikut 2001, i papublikuar)*, çështja e vetme ishte interpretimi i dispozitave përkatëse të Kodit Civil, faktet e shkakut tashmë të përcaktuara, si në njërën procedurë po ashtu edhe në procedurën tjetër. Gjykata vëren veçanërisht, në lidhje me procedurën numër 192/96, se parashtruesi i kërkesës nuk e kundërshtoi në mënyrë adekuate versionin e fakteve të paraqitura nga pala e kundërt, kështu që gjykata në Tomar nuk u ftua të vendosë për faktet e kontestuar, por vetëm për çështjen e së drejtës në kontest.

Në këto kushte, kur duhet të vendosen vetëm çështjet e ligjit, për të cilat kontesti për t'u zgjidhur është më i përshtatshëm për shkrim sesa për parashtrës, shqyrtimi në bazë të shkresave mund të jetë i mjaftueshëm. Në lidhje me këtë, gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë që do ta bindte atë se vetëm faza gojore pas shkëmbimit të deklaratave mund të siguronte drejtësinë e procedurës.

Në fund, Gjykata vëren se në disa raste është legjitime që autoritetet kombëtare të marrin parasysh imperativat e efikasitetit dhe ekonomisë (aktgjykimi *Schuler-Zraggen* i cituar më lart, ibid). Prandaj, në rastet si ky, ku faktet nuk janë kontestuese dhe çështjet juridike nuk janë veçanërisht të ndërlikuara, mosmbajtja e seancës dëgjimore publike nuk cenon kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 në çështjet e oralitetit dhe publicitetit (shih aktgjykimin *Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2)* të cituar më sipër, f. 169, paragrafi 49).

37. Gjithashtu, në rastin *Saccoccia kundër Austrisë*, GJEDNJ iu referua rastit *Speil kundër Austrisë* vendimi, nr. 42057/98, i 5 shtatorit 2002), ku konkludoi se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seancat në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar në detaje;

Gjykata vëren se Gjykata Administrative e refuzoi këtë kërkesë për shkak se konstatoi se autoritetet administrative nuk kishin bërë gabime procedurale dhe se faktet ishin të kontestueshme duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk i kontestoi konstatimet faktike të autoritetit të shkallës së parë. Gjykata vëren se kur faktet nuk janë të kontestueshme dhe Gjykata thirret vetëm për të vendosur çështje ligjore pa kompleksitet të veçantë, mund të mos kërkohej një seancë dëgjimore me gojë sipas nenit 6 paragrafi 1 (shih *Varela Assalino*, cituar më lart, me referenca të mëtejshme). Gjykata konsideron se një situatë e tillë ka ekzistuar në këtë rast sepse Gjykata Administrative është dashur të vendosë vetëm për çështje juridike të cilat, megjithatë, nuk kanë ngritur çështje komplekse. Duke marrë më tej parasysh kërkesat e autoriteteve kombëtare për efikasitet dhe ekonomi (shih vendimin *Schuler-Zraggen* të cituar më lart, f. 20, paragrafi 58), Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata Administrative mund të përmbahet nga mbajtja e një seance dëgjimore.

38. GJEDNJ-ja ka pranuar gjithashtu se heqja dorë nga seanca dëgjimore mund të justifikohet në rastet kur ngrihen vetëm çështje të ligjit që kanë natyrë të kufizuar (shih Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), ku ajo në paragrafët 44-49 arsyetoi:

44. Sipas mendimit të Komisionit, Gjykata e Lartë Administrative, edhe pse ishte e vetmja instancë gjyqësore që ka vepruar në rastin në fjalë, nuk ka qenë e detyruar të mbajë seancë gojore. Kërkesa kryesore e parashtruesit të kërkesës drejtuar gjykatës, për dhënien e lejes së ndërtimit, u rrëzua për shkak të mungesës së juridiksionit. E vetmja çështje që duhej të përcaktohej në merita ishte nëse autoritetet publike kishin të drejtë të tërhiqnin planin e detajuar të zhvillimit në fjalë dhe gjykata arriti në përfundimin se ato ishin të autorizuar ta bënë këtë pavarësisht nga të drejtat që mund të ishin grumbulluar gjatë ekzistencës së planit. Prandaj, faktet konkrete në lidhje me situatën e parashtruesit të kërkesës nuk ishin relevante. Ankesa e tij nuk ngriti asnjë çështje faktike apo juridike që nuk mund të adresohet në mënyrë adekuate në shkresat e lëndës. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës.

45. Qeveria, duke u pajtuar përgjithësisht me Komisionin, theksoi se thelbi i çështjes së shqyrtuar nga Gjykata e Lartë Administrative është nëse vendimi për anulimin e planit të detajuar zhvillimor është në kundërshtim me ligjin. Ligji përkatës ishte i qartë dhe faktet të pakontestueshme, duke lënë pak hapësirë për diskrecionin gjyqësor. Përveç kësaj, vështirë se mund të thuhet se rezultati i procedurës kishte rëndësi për parashtruesin e kërkesës. Shtrirja e të drejtës për seancë gojore në raste të tilla mund të ketë pasoja të rënda për ekspeditet dhe efikasitetin e administrimit të drejtësisë, veçanërisht para gjykatave të apelit ku volumni i punëve është i lartë. Prandaj, kishte arsye të forta që justifikojnë refuzimin e mbajtjes së seancës.

46. Gjykata rikujton se, sipas praktikës së saj gjyqësore, në procedura, si këtu, para gjykatës së shkallës së parë, e drejta për një “dëgjim publik” sipas nenit 6, paragrafi 1, nënkupton të drejtën për një “dëgjim me gojë” përveç rasteve kur ka rrethana të jashtëzakonshme që justifikojnë heqjen dorë nga një seancë e tillë (shih, për shembull, Fredin kundër Suedisë (nr. 2), nr. 18928/91 aktgjykim i 23 shkurtit 1994, Seria A nr. 283-A, f. 10- 11, paragrafët 21-22, Fischer kundër Austrisë, nr. 16922/90, i 26 prillit 1995, Seria A Nr. 312, faqet 20-21, paragrafi 44 dhe aktgjykimi Stallinger dhe Cousso kundër Austrisë i 23 Vendimi 1997-II, fq. 679-80, paragrafi 51).

47. Lidhur me rrethanat e veçanta të procedurës në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë Administrative nuk e konsideroi kompetente zgjidhjen e kërkesës së tij për lëshimin e lejes së ndërtimit. Ajo kishte juridiksion vetëm të merrej me një çështje kolaterale, përkatësisht ligjshmërinë e anulimit të planit të detajuar zhvillimor të vitit 1938.

48. Duke refuzuar ankesën për këtë çështje, Gjykata e Lartë Administrative e bazoi arsyetimin e saj në zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave përkatëse të Kapitullit 17, nenit 4 dhe Kapitullit 5, nenit 11 të Ligjit të vitit 1987, të cilat kanë përcaktuar në mënyrë precize kushte të qarta (shih paragrafët 24 dhe 26 më lart). Gjykata konsideroi se, sipas këtyre dispozitave, plani në fjalë duhet të konsiderohet një plan të cilit i ka skaduar periudha e zbatimit dhe për rrjedhojë mund të ndryshohet ose anulohet pavarësisht nga të drejtat që kanë lindur gjatë ekzistencës së tij. Për më tepër, kjo dispozitë ishte një përjashtim nga Kërkesa e Përgjithshme në Kapitullin 1, Seksioni 5, që gjatë marrjes së vendimeve të planifikimit autoritetet duhet të marrin parasysh interesat individuale dhe jo vetëm interesin publik (ibid). Meqenëse Gjykata e Lartë Administrative miratoi

këtë interpretim të ligjit, ajo nuk duhej të përcaktonte çështjen faktike për interesat individuale të parashtruesit të kërkesës ose, me sa duket, ndonjë pikë tjetër faktike në lidhje me argumentet e tij kundër anulimit të planit detajuar zhvillimor (shih paragrafin 23 më lart).

49. Prandaj, duke pasur parasysh shqyrtimet e mësipërme, Gjykata nuk konstaton, bazuar në provat e paraqitura, se parashtruesat e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Lartë Administrative mund të ngrinin ndonjë çështje faktike ose ligjore në lidhje me të drejtat e tij të ndërtimit që ishin të një natyre të tillë që kërkon një seancë dëgjimore për zgjidhjen e tyre (shih vendimin e lartpërmendur *Fredin (nr. 2)*, f. 11, paragrafi 22). Përkundrazi, duke pasur parasysh natyrën e kufizuar të çështjeve që do të përcaktoheshin, Gjykata e Lartë Administrative, edhe pse vepron si shkallë e parë dhe e vetme gjyqësore në këtë rast, u lirua nga detyrimi i saj i zakonshëm sipas nenit 6 paragrafi 1. Për seancë gojore. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

39. Në fund, GJEDNJ-ja ka pranuar gjithashtu se heqja dorë nga seanca dëgjimore mund të justifikohet në rastet kur ngrihen vetëm çështje ligjore të cilat janë të kufizuara për nga natyra e tyre (shih *Valová, Slezák dhe Slezák kundër Sllovakisë*, cituar më lart), ku në paragrafët 65-69 arsyetoi:

65. Gjykata vëren se në vendimin e saj të datës 30 janar 1998, Gjykata Rajonale në Nitra deklaroi shprehimisht se e vetmja çështje në diskutim ishte një çështje e ligjit: ajo u thirr për të vendosur nëse parashtruesit e kërkesës kishin autorizim, në kuptimin e nenit 4 të Ligjit për pronësinë e tokës, për të kthyer pronën. Nga ky këndvështrim, çështja kryesore ishte nëse kompania private, anëtarët e së cilës ishin paraardhësit e parashtruesve të kërkesës dhe së cilës iu konfiskua toka në fjalë, ishte person juridik.

66. Kjo çështje u përcaktua në aktgjykimin e degës së Nitrës të Gjykatës së Qarkut në Bratisllavë të datës 16 dhjetor 1993, e nxjerrë në kontekstin e procedurës përkitazi me një kërkesë të ndryshme nga parashtruesit e kërkesës për kthim. Para shpalljes së atij aktgjykimi, Gjykata e Qarkut mbajti seancë dëgjimore gjatë së cilës parashtruesit e kërkesës ishin të lirë të paraqisnin argumentet e tyre. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk ishte e nevojshme një seancë tjetër dëgjimore publike në bazë të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës me rastin vendosjes lidhur me këtë rast.

67. Gjykata nuk konstaton, në bazë të provave të paraqitura, se parashtruesat e parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Rajonale në Nitra mund të ngrinin ndonjë çështje faktike ose ligjore në lidhje me kërkesën e tyre për kthim, që ishin të një natyre të tillë që të kërkojnë një seancë gojore në dispozicion të tyre. Në kohën përkatëse, neni 250f i Kodit të Procedurës Civile i mundësonte gjykatat të nxjerrin aktgjykim pa seancë paraprake gojore në raste të ngjashme (shih paragrafin 36 më lart).

68. Duke pasur parasysh shqyrtimet e lartpërmendura dhe duke pasur parasysh natyrën e kufizuar të çështjeve për t'u zgjidhur nga Gjykata Rajonale në Nitra, Gjykata konstaton se mungesa e një seance dëgjimore në procedurën para Gjykatës Rajonale në Nitra nuk ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 i Konventës në rrethanat e veçanta të rastit.

69. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1.

(V) Zbatimi i parimeve bazë të lartpërmendura në rastin konkret

40. Rikujtoj se parashtruesi i kërkesës është një kompani e cila gjatë vitit 1997 ka pasur bashkëpunim afarist me kompaninë “Feronikeli”. Ai bashkëpunim afarist përfshinte detyrimin e parashtruesit të kërkesës për t’i dorëzuar kompanisë “Feronikeli” produktet e saj, të cilat ishin të nevojshme që ajo të zhvillonte pa probleme aktivitetin e saj ekonomik. Pikërisht, gjatë vitit 1997, sipas dokumenteve në shkresat e lëndës, kompania “Feronikeli” ka porositur nga parashtruesi i kërkesës një sasi të caktuar të produkteve të saj, të cilat parashtruesi i kërkesës i ka dorëzuar po atë vit dhe që shihet në bazë të fletëdorëzimit që është në shkresat e lëndës. Me fletëdorëzimin e përmendur vërtetohet se parashtruesi i kërkesës ia ka dorëzuar kompanisë “Feronikeli” sasinë e kontraktuar të produkteve të saj në shumën e përgjithshme prej 1,506,463,00 dinarë jugosllavë në atë kohë, e cila sipas raportit të ekspertit financiar të bërë me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, paraqet shumën prej 271 456 00 euro. Mirëpo, sipas parashtruesit të kërkesës, kompania “Feronikeli” nuk i ka paguar mjetet për produktet e dorëzuara brenda afatit.
41. Pikërisht këto pretendime të parashtruesit të kërkesës se kompania “Feronikeli” nuk përmbushi detyrimet e saj ndaj parashtruesit të kërkesës, sollën situatën që parashtruesi i kërkesës të kërkojë kompensim për të drejtat e tij në një proces gjyqësor, të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ai e kishte iniciuar nga duke parashtruar kërkesë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. Kërkesa, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës, është iniciuar më 26 nëntor 1998 duke shfrytëzuar të drejtën për të dërguar shkresa në gjykatë përmes shërbimit postar. Megjithatë, gjykatat e rregullta nuk mundën të përcaktojnë nga shkresat e lëndës nëse Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë ka ndërmarrë veprime procedurale për të proceduar dhe të vendosjes lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës të vitit 1998.
42. Më 12 maj 2006, parashtruesi i kërkesës vazhdoi procedurën ligjore për të realizuar kërkesat e tij duke paraqitur propozim për përmbarim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër kompanisë “Feronikeli”, të cilin Gjykata e Qarkut e ndërpreu me vendimin [I. Nr. 209/2006] me kundërshtimin e AKP-së, për faktin se kompania “Feronikeli” ka hyrë në procesin e privatizimit. Duke pasur parasysh këtë rrethanë të re, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Autoritetin për Likuidimin e AKP-së lidhur me kërkesën e tij, e cila është refuzuar nga Autoriteti për Likuidimin e AKP-së. Parashtruesi i kërkesës, duke shfrytëzuar mjetet ligjore, ka paraqitur ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së kundër vendimit të organit të likuidimit të AKP-së, të cilin e ka refuzuar pa caktuar seancë dëgjimore, *“duke e konsideruar kërkesën të parashkruar”*.
43. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, në të cilën ai deklaroi, ndër të tjera, faktet e mëposhtme *“se Kolegji i Specializuar i DHPHJS-së nuk e kishte marrë parasysh se parashkrimi ishte ndërprerë nga parashtrimi i padisë në vitin 1998”*, si dhe se *“Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nuk ka mbajtur seancë dëgjimore”*. Kolegji i apelit i DHPGJS-së nxori aktvendim duke refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe duke arsyetuar;

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, prandaj ai duhet të vërtetohet.

Në bazë të nenit 374 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, në fuqi në kohën e krijimit të detyrimeve, kërkesat reciproke në mes personave juridik të cilat dalin nga kontratat e lidhura në mes tyre, parashkruhen në afatin prej 3 vitesh.

Në bazë të nenit 387 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashkrimi ndërprerët kur debitori e pranon borxhin.

Në këtë lëndë borxhi i pretenduar nga ankuesi bazohet në disa fatura të lëshuara nga 1 janar 1997 deri më 31 dhjetor 1997 të cilat ekzistojnë në dosje të lëndës. Parashkrimi i detyrimeve të NSH-së së paditur për ta paguar borxhin në bazë të faturave të lëshuara ka arritur me datë 01 janar 2001.

Ankuesi ka pretenduar se pranimi i borgjit në 2006 për pagimin e faturave të lëshuara në periudhën e cekur si dhe padia e parashtruar në DHPGJS- me 2006 apo para AL ka ndërprerë parashkrimin. Megjithatë prape ai nuk ka arritë ta ndërprejë parashkrimin, ngase ai këtë padi pretendon se e ka parashtruar me 2006, që prapë është më shumë se 3 vite, sa kërkohet me ligj për parashkrimin e kërkesave.

Ankuesi ishte drejtuar tek Autoriteti i Likuidimit edhe me vonë, përkatësisht me datë 21 tetor 2006 që parashkrimi i kërkesës është i padiskutueshëm.

Rrjedhimisht mund të konstatohet se kërkesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor, andaj ajo është parashkruar në kuptim të nenit 374 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në bazë të nenit 387 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, është e qartë se e paditura nuk ka dhënë ndonjë deklaratë me shkrim për pranimin e borxhit, apo ajo nuk ka marrë ndonjë veprim tjetër të tërthortë për njohje të borxhit, të përcaktuar me dispozitën e cekur ligjore, andaj në rastin e këtij ankuesi nuk ka ndërprerje të parashkrimit.

Në bazë të nenit 374 të LMD-së, ankuesi kishte ne dispozicion 3 vite për ta kërkuar borxhin ndaj NSH-së në DHPGJS, mirëpo ai ka dështuar të paraqes padi të afatshme në DHPGJS-ë.

Nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson të saktë Aktgjykimin e shkallës së parë të DHPGJS-së kur Aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Nga këto arsye edhe Kolegji i Apelit konsideron se ankesa e ankuesit duhet refuzuar si e pa bazuar ndërsa Aktgjykimi i ankimuar duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

44. Vetë fakti që Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, ndër të tjera, nuk i kanë dëgjuar palët ndërgjyqëse dhe kanë mbajtur seancë publike janë pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës. në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
45. Duke iu rikthyer rastit konkret për sa më përket mua si gjyqtar, nuk ka asnjë dyshim se nuk është mbajtur seanca para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, siç thuhet në vetë aktgjykim.
46. Gjithashtu, për sa më përket mua si gjyqtar, nuk ka asnjë dyshim që parashtruesi i kërkesës nuk ka hequr dorë nga e drejta e seancës dëgjimore, përkundrazi, është e pakontestueshme që parashtruesi i kërkesës përmes parashtrësës së fundit ka kërkuar mbajtjen e një seance publike në ankesën e paraqitur në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së në parashtrësën e tij të fundit, ku thuhet:

“I autorizuari i paditësit i propozon Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Prishtinë që në rastin e shqyrtimit të ankesës në kuptim të nenit 190 para 4 të LPP, të mbajë seancën gjyqësore për konstatim të drejtë të gjendjes faktike”.

47. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, konstatoj (i) se fakti që parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar seancë dëgjimore para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së nuk nënkupton heqjen dorë nga kjo e drejtë, ii) që parashtruesi i kërkesës shprehimisht ka kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore publike, pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes së cilës lind detyrimi që të shqyrtojë domosdoshmërinë e mbajtjes së seancës; (iii) se parashtruesit të kërkesës iu mohua e drejta për një seancë dëgjimore në të dy nivelet e Kolegjit të DHPGJS-së.
48. Prandaj, në analizën e mëtutjeshme, do të arsyetoj nëse në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që arsyetojnë mungesën e seancës para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS -së.
49. Për më tepër, edhe nëse unë, si gjyqtar individual, dhe gjyqtarët që janë shumicë i referohemi të njëjtës praktikë të GJEDNJ-së, përkatësisht aktgjykimit të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, besoj se shumica e interpreton në mënyrë të gabuar këtë aktgjykim të Dhomës së Madhe, pra e interpreton atë ekskluzivisht nga pikëpamja formaliste derisa të hyjë në thelbin e aktgjykimit dhe rastet e GJEDNJ-së të cilave i referohet ky aktgjykim, të cilat janë përjashtime nga rregulli për detyrimin e një seance publike dhe të cilin e kam shtjelluar në detaje në paragrafët 32-39 të këtij mendimi mospajtues.
50. Përmes një shqyrtimi të detajuar të përjashtimeve të lartpërmendura nga rregulli i përgjithshëm për domosdoshmërinë e një dëgjimi publik, konkludoj se GJEDNJ-ja së pari (I) përcakton se cila çështje ligjore duhet të zgjidhet para gjykatës kompetente, pastaj, (II) nëse me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike është e nevojshme një seancë dëgjimore publike ose e njëjta mund të zgjidhet më lehtë duke shqyrtuar dokumentacionin, dhe në fund (III) nëse dëgjimi i dëshmitarëve, ballafaqimi apo ndonjë veprim që do të lehtësojë zgjidhjen e çështjes në seancë publike janë të nevojshme në përcaktimin dhe zgjidhjen e këtyre çështjeve.

(I) çështja juridike duhet të zgjidhet para gjykatës kompetente,

51. Prandaj, duke ndjekur praktikën konsistente të GJEDNJ-së, përkatësisht të Dhomës së Madhe në aktgjykimin *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, së pari është e nevojshme të përcaktohet se cila çështje ligjore duhet të zgjidhet përpara gjykatës kompetente.
52. Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkesa, përkatësisht konntesti ndërmjet palëve ka lindur për shkak se parashtruesi i kërkesës pretendon se kompania “Feronikel” nuk i ka paguar kërkesat që i kishte borxh. Dhe çështja juridike që gjykatat e rregullta duhet ta përcaktojnë është çështja e përcaktimit të parashkrimit të padisë që parashtruesi i kërkesës e thekson në kërkesëpadinë e tij.
53. Prandaj, konstatoj se gjykatat nuk është dashur të përcaktojnë nëse ka qenë i zbatueshëm neni 374 i Ligjit për marrëdhëniet detyimore, i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të marrëdhënies, i cili përcakton se pretendimet e ndërsjella të personave juridik për kontratat e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe pretendimet për kompensimin e shpenzimeve të bëra në lidhje me ato kontrata, parashkruhen për tri vjet.

54. Gjithashtu, gjykatat e rregullta është dashur të përcaktojnë nëse, bazuar në nenin 387 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore, ka pasur njohje të borxhit dhe nëse ka pasur ndërprerje të parashkrimit, siç pretendoi parashtruesi i kërkesës.
55. Nga sa më sipër, konkludoj se të gjitha çështjet e kontestuara janë “*çështje ekskluzivisht juridike*”, përkatësisht zbatueshmëria e Ligjit për marrëdhëniet detyrimore dhe interpretimi i neneve 374 dhe 387 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore.
56. Rikujtoj se GJEDNJ në rastin Saccoccia kundër Austrisë, cituar më lart, paragrafët 77-78, arriti në përfundimin se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seancat në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar në detaje;

77. Duke iu rikthyer rrethanave të këtij rasti, Gjykata vëren se gjykatat duhej të shqyrtonin nëse ishin përmbushur kushtet e përcaktuara në dispozitat përkatëse të ELAA dhe Traktatit të vitit 1998 për ekzekutimin e një urdhri konfiskimi të pronës. Çështjet që do të shqyrtoheshin përfshinin çështjet e reciprocitetit, nëse aktet e kryera nga parashtruesi i kërkesës ishin të dënueshme sipas ligjit austriak në kohën kur u kryen, respektimi i afateve kohore ligjore dhe nëse procedurat pranë Gjykatës së Qarkut të Rhode Island, e cila dha urdhrin për konfiskim, ishte në përputhje me standardet e nenit 6 të Konventës.

78. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo procedurë kishte të bënte më tepër me çështje teknike të bashkëpunimit ndërshtetëror në luftën kundër pastrimit të parave nëpërmjet ekzekutimit të një urdhri konfiskimi të huaj. Ata ngritën vetëm çështje ligjore të një natyre të kufizuar. Gjithçka që gjykatat austriake duhej të përcaktonin ishte nëse kushtet e përcaktuara në ELAA dhe në Traktatin e vitit 1998 për autorizimin e ekzekutimit të një urdhri konfiskimi ishin përmbushur. Siç është përcaktuar tashmë (shih paragrafët 63-64 më lart), procedurat nuk përfshinin një rivlerësim të bazueshmërisë së urdhrin të konfiskimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit të Rhode Island.

57. Për më tepër, GJEDNJ në rastin Varela Assalino kundër Portugalisë nr. 64336/01, të 25 prillit 2002, ku konkludoi se janë të përfshira “*çështje ekskluzivisht ligjore*” dhe arsyetoi;

Në sytë e Gjykatës, ky përfundim nuk mund të konsiderohet i paarsyeshëm. Në të vërtetë, procedura kontestimore nuk ngritën ndonjë çështje e cila nuk mund të zgjidhej në mënyrë adekuate në bazë të shkresave. Ndryshe nga rasti Malhous (Malhous kundër Republikës Çeke [DHM], nr. 33071/96, aktgjykimi i 12 korrikut 2001, i papublikuar), çështja e vetme ishte interpretimi i dispozitave përkatëse të Kodit Civil, faktet e shkakut tashmë të përcaktuara, si në njërën procedurë po ashtu edhe në procedurën tjetër. Gjykata vëren veçanërisht, në lidhje me procedurën numër 192/96, se parashtruesi i kërkesës nuk e kundërshtoi në mënyrë adekuate versionin e fakteve të paraqitura nga pala e kundërt, kështu që gjykata në Tomar nuk u ftua të vendosë për faktet e kontestuara, por vetëm për çështjen e së drejtës në kontest.

Në këto kushte, kur duhet të vendosen vetëm çështjet e ligjit, për të cilat kontesti për t'u zgjidhur është më i përshtatshëm për shkrim sesa për parashtrës, shqyrtimi në bazë të shkresave mund të jetë i mjaftueshëm. Në lidhje me këtë, gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë që do ta bindte atë se vetëm faza gojore pas shkëmbimit të deklaratave mund të siguronte drejtësinë e procedurës.

Në fund, Gjykata vëren se në disa raste është legjitime që autoritetet kombëtare të marrin parasysh imperativat e efikasitetit dhe ekonomisë (aktgjykimi Schuler-Zraggen i cituar më lart, ibid). Prandaj, në rastet si ky, ku faktet nuk janë kontestuese dhe çështjet juridike nuk janë veçanërisht të ndërlikuara, mosmbajtja e seancës dëgjimore publike nuk cenon kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 në çështjet e oralitetit dhe publicitetit (shih aktgjykimin Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2) të cituar më sipër, f. 169, paragrafi 49).

58. Më pas, GJEDNJ pranoi gjithashtu se heqja dorë nga seanca dëgjimore mund të justifikohet në rastet kur ngrihen vetëm çështje ligjore të cilat janë të kufizuara në natyrë (shih Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), ku në paragrafin 48 arsyetoi:

48. Duke refuzuar ankesën për këtë çështje, Gjykata e Lartë Administrative e bazoi arsyetimin e saj në zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave përkatëse të Kapitullit 17, nenit 4 dhe Kapitullit 5, nenit 11 të Ligjit të vitit 1987, të cilat kanë përcaktuar në mënyrë precize kushte të qarta (shih paragrafët 24 dhe 26 më lart). Gjykata konsideroi se, sipas këtyre dispozitave, plani në fjalë duhet të konsiderohet një plan të cilit i ka skaduar periudha e zbatimit dhe për rrjedhojë mund të ndryshohet ose anulohet pavarësisht nga të drejtat që kanë lindur gjatë ekzistencës së tij. Për më tepër, kjo dispozitë ishte një përjashtim nga Kërkesa e Përgjithshme në Kapitullin 1, Seksioni 5, që gjatë marrjes së vendimeve të planifikimit autoritetet duhet të marrin parasysh interesat individuale dhe jo vetëm interesin publik (ibid). Meqenëse Gjykata e Lartë Administrative miratoi këtë interpretim të ligjit, ajo nuk duhej të përcaktonte çështjen faktike për interesat individuale të parashtruesit të kërkesës ose, me sa duket, ndonjë pikë tjetër faktike në lidhje me argumentet e tij kundër anulimit të planit detajuar zhvillimor (shih paragrafin 23 më lart).

59. Nisur nga sa më sipër, konkludoj se GJEDNJ në të gjitha rastet kur çështja juridike ka të bëjë me interpretimin e normës juridike të zbatimit të saj, përcaktimin e ekzistimit të të drejtave në pajtim me normën juridike, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se mosmbajtja e seancës dëgjimore publike nuk është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së.

(II) nëse me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje juridike është e domosdoshme një seancë publike apo ajo mund të zgjidhet më lehtë duke shqyrtuar dokumentacionin

60. Më tej, duke ndjekur praktikën konsistente të GJEDNJ-së, përkatësisht të Dhomës së Madhe në aktgjykimin Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë çështja e dytë që GJEDNJ vendos për të përcaktuar nëse një seancë dëgjimore publike është e nevojshme është çështja nëse një seancë dëgjimore publike është e nevojshme kur zgjidhet një çështje ligjore ose mund të zgjidhet më lehtë duke shqyrtuar dokumentacionin.
61. Duke iu rikthyer rastit konkret, rikujtoj se të gjitha çështjet kontestuese janë “*çështje ekskluzivisht juridike*”, përkatësisht zbatueshmëria e Ligjit për marrëdhëniet detyimore, dhe interpretimi i neneve 374 dhe 387 të Ligjit për marrëdhëniet detyimore.
62. Rikujtoj se parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, i cili nxori aktgjykimin [C-IV- 14-5731], duke refuzuar padinë e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës si të papabazuar, duke arsyetuar;

Vendimi është nxjerrë pa mbajtur seancë gjyqësore për shkak se faktet dhe provat në lëndë janë mjaft të qarta, prandaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të sillen më shumë informata dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 i Ligjit për DHPGJS (nr. 06 L-086).

Paditësi ka kërkuar borxhin në shumën prej 271.456 euro, duke theksuar se të paditurin e ka furnizuar me produkte të ndryshme nga 1 janari 1997 deri më 31 dhjetor 1997, në bazë të marrëdhënieve të rregullta afariste.

Afati kohor për të cilën paditësi kishte kërkuar borxhin ka skaduar me datë 31 dhjetor 2000.

Kërkesa është paraqitur më 21 tetor 2006 pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së.

Paditësi këtë borxh nuk e kishte kërkuar asnjëherë me padi nga e paditura me padi gjyqësore të parashtruar pranë ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent.

Afati për dorëzimin e kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e borxhit ka filluar të rrjedhë më 31 dhjetor 1997.

Sipas Nenit 374 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 29/1978 i cili ka qenë i aplikueshëm në atë kohë parasheh që kërkesat reciproke të personave shoqëror juridik nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shërbimet e bëra lidhur me këto kontrata parashkruhen për tri vjet”.

Në bazë të provave të parashtruara nga paditësi gjykata vlerësoi se nuk është iniciuar kurrfarë procedure pranë ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent për të kërkuar borxhin e pretenduar.

Prandaj, Gjykata ka ardhur në përfundim se padia në fjalë në tërësi refuzohet si e pabazuar pasi që ajo është parashkruar. Afati i parashkrimit nuk ishte ndërprerë dhe për këtë paditësi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi.”

Duke pasur parasysh, afatin e parashkrimit, Gjykata është e obliguar që në tërësi ta refuzojë padinë ashtu siç u tha në dispozitiv.

63. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së nxori një aktvendim me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke arsyetuar;

Në këtë lëndë borxhi i pretenduar nga ankuesi bazohet në disa fatura të lëshuara nga 1 janar 1997 deri më 31 dhjetor 1997 të cilat ekzistojnë në dosje të lëndës. Parashkrimi i detyrimeve të NSH-së së paditur për ta paguar borxhin në bazë të faturave të lëshuara ka arritur me datë 01 janar 2001.

Parashkrimi i detyrimeve të NSH-së së paditur për ta paguar borxhin në bazë të faturave të lëshuara ka arritur me datë 01 janar 2001.

Ankuesi ka pretenduar se pranimi i borgjit në 2006 për pagimin e faturave të lëshuara në periudhën e cekur si dhe padia e parashtruar në DHPGJS- me 2006 apo para AL ka ndërprerë parashkrimin. Megjithatë prape ai nuk ka arritë ta ndërprejë parashkrimin, ngase ai këtë padi pretendon se e ka parashtruar me

2006, që prapë është më shumë se 3 vite, sa kërkohet me ligj për parashkrimin e kërkesave.

Ankuesi ishte drejtuar tek Autoriteti i Likuidimit edhe me vonë, përkatësisht me datë 21 tetor 2006 që parashkrimi i kërkesës është i padiskutueshëm.

Rrjedhimisht mund të konstatohet se kërkesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor, andaj ajo është parashkruar në kuptim të nenit 374 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

64. Bazuar në sa më sipër, konkludoj se “çështjet ekskluzivisht ligjore” janë ngritur para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (i) kur borxhi ka lindur në bazë të ligjeve në fuqi, (ii) nëse ka pasur një ndërprerje të parashkrimit bazuar në ligjet në fuqi, dhe (iii)) nëse parashkrimi ka ndodhur në bazë të ligjeve në fuqi.
65. Para së gjithash, vërej se çështja e parë (i) kur lindi borxhi në bazë të ligjeve në fuqi, gjykatat e rregullta kanë mundur të përcaktojnë vetëm në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në të cilin ai pretendonte se kishte furnizuar të paditurin me produkte të ndryshme nga 1 janari 1997 deri më 31 dhjetor 1997, bazuar në një marrëdhënie të rregullt afariste.
66. Për më tepër, vërej se çështja e dytë (ii) nëse ka pasur ndërprerje të parashkrimit në bazë të ligjeve të vlefshme, kanë mundur të përcaktojnë vetëm në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në gjykatat e rregullta, përkatësisht dëshmi me shkrim se ka ardhur deri te njohja e borxhit, ose me dëshmi me shkrim se ka kërkuar shlyerjen e borxhit duke parashtruar padi pranë gjykatave të rregullta brenda afatit të duhur.
67. Në fund, vërej se çështja e tretë (iii) nëse parashkrimi ka ndodhur në bazë të ligjeve të vlefshme, gjykatat e rregullta kanë mundur ta përcaktojnë vetëm në bazë të dokumentacionit të ofruar nga parashtruesi i kërkesës, përkatësisht provave me shkrim se përmes padisë në gjykatat e rregullta në afatin e duhur ka kërkuar kthimin e borxhit.
68. Rikujtoj se GJEDNJ-së në rastin Döry kundër Suedisë, cituar më lart, paragrafët 37-45, paragrafët 43-45, GJEDNJ arriti në përfundimin se kishte rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca dëgjimore në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar në detaje;

43. Në këto rrethana, duhet të konkludohet se kontesti në rastet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Administrative të Apelit, kishte të bënte me interpretimin e duhur të provave mjekësore me shkrim. Gjykata vlerëson se gjykata e apelit mund ta zgjidhte në mënyrë adekuate këtë çështje bazuar në certifikatat përkatëse mjekësore dhe parashtruesat me shkrim të parashtruesit të kërkesës. Në lidhje me këtë, ajo vëren se parashtruesja e kërkesës, në vendimet për refuzimin e kërkesave të saj për seancë gojore, është ftuar nga gjykata e apelit të paraqesë vërejtjet përfundimtare me shkrim.

44. Gjykata merr parasysh më tej se parashtruesja e kërkesës nuk i kërkoj Gjykatës Administrative të Apelit të thërriste dëshmitarë dhe nuk u mbështet në asnjë provë tjetër gojore. Në të vërtetë, ajo nuk ka deklaruar arsyet e kërkesave të saj që gjykata e apelit të mbajë seanca dëgjimore për rastet.

45. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se kanë ekzistuar rrethanat e jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca në rastet e

parashtrueses së kërkesës. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës.

69. Më pas GJEDNJ në rastin Saccoccia kundër Austrisë paragrafi 79, GJEDNJ arriti në përfundimin se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seancat në rastet e kërkuarit, duke shpjeguar në detaje;

79. Kjo procedurë nuk kërkonte dëgjimin e dëshmitarëve apo paraqitjen e provave të tjera gojore. Për më tepër, Gjykata pajtohet me Qeverinë që gjykatat nuk ishin ftuar të dëgjonin personalisht parashtruesin e kërkesës. Procedurat nuk ngritën asnjë çështje për besueshmërinë e tij, as nuk kishin të bënin me ndonjë rrethanë që do t'i kërkonte gjykatave të krijonin një përshtypje personale për parashtruesin e kërkesës. Në këto rrethana, gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme rastin në bazë të parashtrësive me shkrim të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim. Prandaj, ato u liruan nga mbajtja e seancës dëgjimore.

70. GJEDNJ më tej në rastin Varela Assalino kundër Portugalisë nr. 64336/01, të 25 prillit 2002, ku konkludoi se kanë të bëjnë me “çështje ekskluzivisht ligjore” dhe arsyetoi;

Në këto kushte, kur duhet të vendosen vetëm çështjet e ligjit, për të cilat kontesti për t'u zgjidhur është më i përshtatshëm për shkrim sesa për parashtrësia, shqyrtimi në bazë të shkresave mund të jetë i mjaftueshëm. Në lidhje me këtë, gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë që do ta bindte atë se vetëm faza gojore pas shkëmbimit të deklaratave mund të siguronte drejtësinë e procedurës.

71. Më pas, GJEDNJ pranoi gjithashtu se heqja dorë nga seanca dëgjimore mund të justifikohet në rastet kur ngrihen vetëm çështje ligjore të cilat janë të kufizuara për nga natyra e tyre (shih Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 2), cituar më lart, ku në paragrafin 49 arsyetoi:

49. Prandaj, duke pasur parasysh shqyrtimet e mësipërme, Gjykata nuk konstaton, bazuar në provat e paraqitura, se parashtrësit e parashtrësive të kërkesës në Gjykatën e Lartë Administrative mund të ngrinin ndonjë çështje faktike ose ligjore në lidhje me të drejtat e tij të ndërtimit që ishin të një natyre të tillë që kërkon një seancë dëgjimore për zgjidhjen e tyre (shih vendimin e lartpërmendur Fredin (nr. 2), f. 11, paragrafi 22). Përkundrazi, duke pasur parasysh natyrën e kufizuar të çështjeve që do të përcaktoheshin, Gjykata e Lartë Administrative, edhe pse vepron si shkallë e parë dhe e vetme gjyqësore në këtë rast, u lirua nga detyrimi i saj i zakonshëm sipas nenit 6 paragrafi 1. Për seancë gojore. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

72. Në fund, GJEDNJ-ja pranoi gjithashtu se heqja dorë nga seanca dëgjimore mund të justifikohet në rastet kur ngrihen vetëm çështje ligjore që janë të kufizuara për nga natyra e tyre (shih Valová, Slezák dhe Slezák kundër Sllovakisë, cituar më lart), ku në paragrafin 67 arsyetoi:

67. Gjykata nuk konstaton, në bazë të provave të paraqitura, se parashtrësit e parashtrësive të kërkesës në Gjykatën Rajonale në Nitra mund të ngrinin ndonjë çështje faktike ose ligjore në lidhje me kërkesën e tyre për kthim, që ishin të një natyre të tillë që të kërkojnë një seancë gojore në dispozicion të tyre. Në kohën përkatëse, neni 250f i Kodit të Procedurës Civile i mundësonte gjykatat të

nxjerrin aktgjykim pa seancë paraprake gojore në raste të ngjashme (shih paragrafin 36 më lart).

73. Në bazë të sa më sipër, konkludoj se GJEDNJ në të gjitha rastet kur çështja juridike mund të përcaktohet më mirë me shkrim, GJEDNJ mbajti qëndrimin se mungesa e mbajtjes së seancës dëgjimore nuk është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së.

(III) nëse dëgjimi i dëshmitarëve, ballafaqimi ose ndonjë veprim që do të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve kontestuese përmes një seance publike është i nevojshëm për përcaktimin dhe zgjidhjen e çështjeve të kontestuara

74. Në fund, duke ndjekur praktikën konsistente të GJEDNJ-së dhe Dhomës së Madhe në vendimin Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, çështja e tretë që GJEDNJ bën për të përcaktuar nëse është e nevojshme një seancë dëgjimore publike është çështja nëse përcaktimi dhe zgjidhja e çështjeve kontestuese kërkon dëgjimin e dëshmitarëve, ballafaqim ose një veprim që do të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve kontestuese në një seancë publike.
75. Duke iu rikthyer rastit konkret, rikujtoj se të gjitha çështjet kontestuese janë “*çështje ekskluzivisht ligjore*”, përkatësisht aplikimi i Ligjit për marrëdhëniet detyrimore dhe interpretimi i neneve 374 dhe 387 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore.
76. Më tej, vë në dukje se parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar që të dëgjohet ndonjë dëshmitar ose të zhvillohet një ballafaqim ose të paraqiten prova që nuk mund të paraqiten pa mbajtur një seancë dëgjimore publike.
77. Rikujtoj gjithashtu se para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, i cili ka nxjerrë aktgjykimin [C-IV- 14-5731], me të cilin është refuzuar padia e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, arsyetoi;

Vendimi është nxjerrë pa mbajtur seancë gjyqësore për shkak se faktet dhe provat në lëndë janë mjaft të qarta, prandaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të sillen më shumë informata dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 i Ligjit për DHPGJS (nr. 06 L-086).

78. Së pari, GJEDNJ në rastin Döry kundër Suedisë paragrafi 44, GJEDNJ arriti në përfundimin se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca dëgjimore në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar në detaje;

44. Gjykata merr parasysh më tej se parashtruesja e kërkesës nuk i kërkoj Gjykatës Administrative të Apelit të thërriste dëshmitarë dhe nuk u mbështet në asnjë provë tjetër gojore. Në të vërtetë, ajo nuk ka deklaruar arsyet e kërkesave të saj që gjykata e apelit të mbajë seanca dëgjimore për rastet.

79. Më pas, GJEDNJ në rastin Saccoccia kundër Austrisë, paragrafët 79-80, GJEDNJ arriti në përfundimin se ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme që justifikonin heqjen dorë nga seanca dëgjimore në rastet e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar në detaje;

79. Kjo procedurë nuk kërkonte dëgjimin e dëshmitarëve apo paraqitjen e provave të tjera gojore. Për më tepër, Gjykata pajtohet me Qeverinë që gjykatat nuk ishin ftuar të dëgjonin personalisht parashtruesin e kërkesës. Procedurat nuk ngritën asnjë çështje për besueshmërinë e tij, as nuk kishin të bënin me ndonjë rrethanë që do t'i kërkonte gjykatave të krijonin një përshtypje personale për parashtruesin e kërkesës. Në këto rrethana, gjykatat mund të vendosin në

mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme rastin në bazë të parashtrësve me shkrim të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim. Prandaj, ato u liruan nga mbajtja e seancës dëgjimore.

80. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1.

80. Bazuar në sa më sipër, konkludoj se GJEDNJ në të gjitha rastet kur një çështje juridike mund të zgjidhej pa dëgjuar dëshmitarët dhe paraqitur prova që mund të paraqiten vetëm në një seancë publike, dhe se çështjet ligjore mund të përcaktohen më mirë duke paraqitur me shkrim, GJEDNJ mbajti qëndrimin e mosmbajtjes së seancës dëgjimore publike,

(V) Përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës

81. Bazuar në sa më sipër dhe duke marrë parasysh praktikën e vendosur të GJEDNJ-së, duke përcjellë vazhdimisht praktikën e GJEDNJ-së, përkatësisht të Dhomës së Madhe në aktgjykimin Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë, unë si gjyqtar individual konkludoj se në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që arsyetojnë mungesën e seancës dëgjimore pranë Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS -së, dhe;


- I. se GJEDNJ në të gjitha rastet kur çështja juridike ka të bëjë me interpretimin e normës juridike të zbatimit të saj, përcaktimin e ekzistencës së të drejtave në pajtim me normën juridike, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se mosmbajtja e seancës dëgjimore publike nuk është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së.
 - II. se GJEDNJ në të gjitha rastet kur çështja juridike mund të përcaktohet më mirë me paraqitjen me shkrim, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se mosmbajtja e një seance dëgjimore publike nuk është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së.
 - III. se GJEDNJ në të gjitha rastet kur një çështje juridike mund të zgjidhej pa dëgimin e dëshmitarëve dhe paraqitjen e provave që mund të paraqiten vetëm në një seancë publike, dhe se çështjet ligjore mund të përcaktohen më mirë me paraqitjen e një deklarate me shkrim, GJEDNJ vlerësoi se mosmbajtja e një seance dëgjimore publike nuk është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ.
82. Konsideroj se asnjë parashtrues i kërkesës nuk i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese vetëm për të pasur të drejtën në seancë dëgjimore ose ndonjë të drejtë tjetër procedurale, përkundrazi, çdo parashtrues i kërkesës iu drejtua Gjykatës për të realizuar një të drejtë thelbësore, përkatësisht një të drejtë efektive që pretendon se i takon atij.
83. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës iu drejtua gjykatës për kompensim të kërkesës së tij dhe gjykatat e rregullta i dhanë atij mundësinë për të paraqitur provat e tij, gjë që parashtruesi i kërkesës e bëri.
84. Detyra e gjykatës është që fillimisht të përcaktojë nëse ka shkelje dhe ta korrigjojë atë duke i mundësuar parashtruesit të kërkesës të ushtrojë të drejtën substanciale që ka kërkuar parashtruesi i kërkesës dhe jo t'i sigurojë atij një të drejtë procedurale që nuk është efektive.
85. Konkludoj se në rrethanat e rastit konkret ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që arsyetojnë mungesën e seancës para Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjit

të Apelit të DHPGJS-së, sepse të gjitha provat mund të ishin paraqitur me shkrim, që në rastin konkret është më i përshtatshëm për vërtetimin e provave.

86. Për sa më sipër, konkludoj se nuk ka shkelje të së drejtës për një seancë dëgjimore nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së siç është paraqitur në aktgjykim.
87. Më tej, konsideroj se me këtë vendim të shumicës, ne e ekspozojmë parashtruesin e kërkesës ndaj procedurave të reja gjyqësore dhe shpenzimeve shtesë që janë rreptësisht formale për sa i përket mbajtjes së një seance publike, duke e bërë të pamundur ushtrimin e të drejtave thelbësore të parashtruesit të kërkesës.
88. Në fund, edhe nëse interpretimi im i rrethanave të jashtëzakonshme që justifikojnë mungesën e seancës në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk është i saktë, duke marrë parasysh rrethanat në rastin konkret, shumica e gjyqtarëve duhet të kishte përcaktuar në aktgjykim shkeljen e natyrës deklarative si satisfaksion moral për parashtruesin e kërkesës, për të mos e ekspozuar atë në mënyrë të panevojshme ndaj procedurave të reja gjyqësore dhe shpenzimeve shtesë që janë rreptësisht formale për sa i përket mbajtjes së një seance publike pa mundësinë që parashtruesi i kërkesës të ushtrojë të drejtat e tij thelbësore.

Mendimi mospajtues është paraqitur nga gjyqtari;

Radomir Laban, gjyqtar



Më 30 janar 2023 në Prishtinë